

8SH-22

P 93



# DASME PA NUSE

(KOMEDI)

NAUM PRIFTI



891.P85-22

NAUM PRIFTI

P 93

S

# DASMË PA NUSE

(KOMEDI)

1976J

~~SECRET~~

SUTÉPIA BOTUESE «NAIM FRASHÉRI»

## PERSONAZHET

1. NAMIK HASA
2. HAXHI HASA
3. SHEGË HASA
4. GAZMIR STRUGA
5. VEIZ ÇIKA
6. SPIRO DEVOLLIU
7. FEMI THANA
8. MURAT ÇUKA
9. SHERO NARECI
10. NASI HILA
11. DAJUA
12. SİKA GJINI

Personazhe pa emër:

Punëtorë të puseve, krushq, dasmorë, një grua, disa vajza, fshatarë dhe një orkestër.

## PARA PERDES

NAMIKU — Kjo komedi filloi kështu: Një vit përpara, Spirua, banakieri i mencës, vendosi të kalonte në prodhim, sepse i mbaroi raporti për punë të lehtë. Shefi atëhere tha se do të ish mirë të merrnin në vend të tij, ndonjë vajzë nga fshati ose ndonjë grua dhe këtë detyrë ma ngarkoi mua. Punëtorët e shpimit janë si zogjtë e qyqes, nuk ndërtojnë fole, sepse sot janë këtu e mbas një viti kushedi se ku. Ata ngrejnë kulla të larta prej hekuri, baraka druri dhe zgjatin duart e tyre të çelnikta dy mijë, tremijë metra thellë nën tokë, për të kërkuar gaz e naftë dhe pastaj si të qëllojë puna, po s'gjetën gjë ikin më tutje, po gjetën... thërrasin punëtorët e shfrytëzimit dhe u thonë: këtu keni gaz, këtu keni naftë dhe përsëri ikin, ikin për të kërkuar më tej. Është një punë e bukur, unë i kam parë sepse një pus ka qëlluar të shpohet afër shtëpisë sonë...

NJË SPEKTATOR — Sikur e zgjate shumë shoku Namik. S'ka lezet.

NAMIKU — Ke të drejtë. Më fal. (*Matet të ikë*) Po ku e kishim fjalën?

NJË SPEKTATOR — Te komedia, pra.

NAMIKU — (*Kujtohet*) Ah, po. Puna ish se Spirua iku dhe menca mbeti pa banakier. Atëhere unë vajta në shtëpinë e xhaxhait dhe i thërrita. (*Kthehet nga perdja dhe thërrret*) Xhaxha! (*Asnjë përgjigje*) O xha-xha Haxhi! (*Në vend të përgjegjes dëgjohet një kollë*) Brenda qenka!

## HAPET PERDJA

Shtëpia e Haxhi Hasës. Prapa saj, në sfond duket skeleti i kullës së një pusi. Ambienti është i bukur, tipik myzeqar. Në anën e majtë një tufë e dëndur kallamash, të cilat së largu duken si palma. Në anën e djathë të një pus.

NAMIKU — Ç'bën o xhaxha?

HAXHIU — (Duke ngritur sytë nga libri.) Nuk më shikon, a?

NAMIKU — Çudi, gjithmonë me këtë libër të gjej ndër duar. Kaq i bukur qenka?

HAXHIU — Shumë i bukur.

NAMIKU — Si e ka titullin?

HAXHIU — Si ky libër zor se gjen.

NAMIKU — E kush e ka shkruar?

HAXHIU — Librat e tjera, përpëra këtij, s'vlejnë një grosh. Ç'do ti këtu e nuk e gjen? Do të të them si quhet mbreti i Austrisë?

NAMIKU — Me sa di unë, Austria s'ka mbret.

HAXHIU — Ehë! Ato mos m'i shit mua. Unë e kam të shkruar këtu... Do të të them sa njerëz ka Frëngjia? Do të të them cili njeri i ka mustaqet më të gjata në botë?

NAMIKU — Mirë, o xhaxha, e mora vesh, po si e ka titullin?

HAXHIU — Kalendar. Kalendari kombiar i vitit 1916.

NAMIKU — Ah, shumë bukur. Paska lajme të reja!

HAXHIU — Të reja, të vjetra, mirë është t'i dijë njeriu. (Pauzë). Një gjë më ka bërë një nënshtypje të madhe. Në Jemen s'paska turp më të madh se sa kur çupa e nisur nuse, mbetet në shtëpinë e babait më shumë se njëzet e katër orë. Tamam si zakoni ynë, ore!

NAMIKU — Edhe atje Turqia ka qenë.

HAXHIU — Ja, do ta dëgjosh? Në Jemen kanë këtë

*zakon: Cupa, kur niset nuse, lipset tē martohet ndë 24 orë e sipër, ndryshe quhet e ve dhe nuku pitiq tē martohet me djalë. Nuku pitiq.*

NAMIKU — Kur ta mbarosh, ma jep dhe mua t'i hedh një sy.

HAXHIU — Kërkomë ç'të duash, vetëm këtë libër jo. S'ta jap dot, o nipçe, se e di që do ma humbasësh si ato tē tjerat. Ç'ma bëre kuranin, pse s'ma ktheve?

NAMIKU — Ma hëngri gomari. (*Haxhiu vrënjetet.*) Për nder, xhaxha, e hëngri. Ai ha çdo libër që t'i ja-pësh. Unë habitem si nuk e dalloj dot që ishte kuran...

HAXHIU — Hy, gremisu!

NAMIKU — E di pse kam ardhur unë, o xhaxha?

HAXHIU — Thua'ma që ta di.

NAMIKU — Për punën e Shegës.

HAXHIU — (*Me inter̄sim*) E si? Mos...

NAMIKU — Është një rast i mirë.

HAXHIU — (*I cliruar.*) I mirë, i keq, ne e dhamë fjalën njëherë. (*I kthen krahët.*)

NAMIKU — Nuk e kam fjalën për fejesë. Në mencën e zonës së gazit, lirohet një vend...

HAXHIU — Dhe pastaj?

NAMIKU — Unë mendova për Shegën. Nuk do të jetë keq sikur tē vejë atje. (*Haxhiu kollitët dhe luan nga vendi.*) Nuk tē pëlqen, hë?

HAXHIU — E si do tē më pëlqeje? Nuk e di ti që ajo është e fejuar?

NAMIKU — E di dhe prandaj erdha me vrap. Rast më tē mirë se ky s'kemi për tē gjetur. Qe fati ynë që shpimin e pusit e caktuan këtu, njëqind metra larg nga shtëpia jote. Të tjerët i luten punës, kurse ty po tē lutet dhe i bën nazë.

HAXHIU — Rri, mos na ngatërrro andej se, që kur erdhën ata tē puseve, u tërbuat ju rinia, jo mbrëmje, jo shpërfaqje, ekstrada...

NAMIKU — Është gjallëruarjeta, xhaxha, edhe

këtu në fshat. (*I kthen krahët.*) Mirë, si të duash. Në mos vaftë Shega, do vejë dikush tjetër, vendi bosh nuk do mbetet se është punë me... (*Fërkon gishtérinjtë sikur numéron para.*) A nuk do të jetë më lehtë edhe përtty? Se ja, edhe martesa po afron.

HAXHIU — (*Krruan kokën*) Eh, ta dish hallin tim. Gjumi natën s'më zë kur mendoj harxhet e martesës.

NAMIKU — E po, atëhere?

HAXHIU — Halli i botës...

NAMIKU — Punën s'e ka të rëndë. E ç'do të bëjë atje? Do lajë, do fshijë, me një fjalë ato punë që bën edhe në shtëpi. S'ka më mirë xhaxha. (*Haxhiu thotë jo me kokë*). Pastaj, kur të zihet vendi, unë e di që do më lutesh, po atëhere, s'kam ç'të të bëj. E di që do pendoresh si një e një bëjnë dy.

HAXHIU — S'e ke keq, xhanëm, po duhet të pyesin edhe krushqit. Japin lejë, a s'japin lejë, a?

NAMIKU — Ah, atëhere më fal. Këtë unë s'e kam ditur.

HAXHIU — E po, ashtu, ta dish...

NAMIKU — (*Emfatik.*) Nuk e paskam ditur se në shtëpinë e Haxhi Hasës, urdhërokan krushqit e Sulovës. Kur qenka kështu, unë kot paskam ardhur këtu, më mirë të shkoja në Sulovë e të pyesnja krushqit: E lejoni Shegën apo jo?

HAXHIU — (*I fyter në krenarinë e tij*) Në shtëpinë time zot jam unë dhe unë pyetem.

NAMIKU — E po atëhere?

HAXHIU — Kurse çupa është gjysma ime dhe gjysma e tyre.

NAMIKU — Mirë, ti dërgo vetëm gjysmën tënde në punë.

HAXHIU — (*Qesh dhe pastaj vrenjitet menjëherë*) Më fute në mendime, o nipçë.

NAMIKU — A do të vija unë, po të mos ish përtë mirën e shtëpisë? Unë Shegën e kam si motë. Pastaj,

sikur do jetë vetëm. Atje punojnë edhe vajza, edhe gratë tjera.

HAXHIU — Mirë, xhanëm, po kemi hallin e krushqisë.

NAMIKU — Sot gjithë bota me punë rrojnë, o xhaxha. Në tështë se ata janë aqë prapanikë sa nuk duan që ajo të dalë në punë, atëhere lipsur qoftë edhe kjo krushqi.

HAXHIU — (*I vrënjtur*) jo, ore, s'është ashtu...

NAMIKU — (*Ja bën qejfin*) Haxhi Hasa është i zgjuar vetë.

HAXHIU — Tani po, the një fjalë me mend. Ah kur do ti, kur do...

NAMIKU — Ata ta kanë për nder që kanë bërë krushqi me ty.

HAXHIU — Ashtu, posa.

NAMIKU — Atëhere Shega që nesër mund të fillojë nga puna.

HAXHIU — (*Duke i shkelur synë*). Sa do ta ketë rrrogën?

NAMIKU — Mbi katërmijë.

HAXHIU — (*E afron*) Mos na i vijë ndonjë zagar rrrotull?

NAMIKU — Mos këi merak, xhaxha, ata janë djem të mirë. Pastaj edhe unë atje do jem, e shpie, e sjell.

HAXHIU — Për të shpënë e për të sjellë jam vete. E po dalçim faqe bardhë. Ulu të pijmë nga një raki.

NAMIKU — Po Shega ku është?

HAXHIU — Aty te pusi, po lan rrobat (*Thérret*) Oj Shegë, Shegë moj!

SHEGA — (*Që nga jashtë*) Urdhëro, baba!

(*Shega hyn me duar gjithë shkumë.*)

HAXHIU — Na bjerë atë shishen e rakisë se do të japim një lajm të mirë.

(*Ajo pyet me sy Namikun për të marrë vesh ndonjë hollësi. Ai i bën me shenjë se puna është në rregull. Xhaxhai u bind.*)

NAMIKU — Kur ke ndér mend ta martosh, o Xhaxha?

HAXHIU — Dasmën do ta bëjmë kur tē dalë gruri i ri. Zakoni kështu e do; grurë tē ri dhe hënë tē vjetër.

NAMIKU — Po pse, ç'ka tē bëjë hëna e vjetër?

HAXHIU — Hë, ka tē bëjë shumë, po ti s'e di. Ja, pri një dru në hënë tē re, do tē kalbet menjëherë; pri me hënë tē vjetër, tē tē rrojë sa tē jetë jeta.

NAMIKU — Kjo është pesë me hiç.

HAXHIU — Pse e shpie larg? Ti shiko kalendarin, me tē riun moti s'përpinqet gjékundi, me tē vjetrin shkojnë si vëllezër binjakë. Sa ka muaji sot?

NAMIKU — Trembëdhjetë shtator.

HAXHIU — Për ty ka trembëdhjetë ditë vjeshta që ka hyrë, kurse pér mua hyn nesër.

NAMIKU — Xhaxha, ti je prapa, duhet tē ecësh me hapin e kohës, pérndryshe koha do tē tallet me ty.

HAXHIU — Pa ç'më shet mënd! Mua do më mësosh ti?!

(Shega vjen më gotat dhe shishen e rakisë.)

NAMIKU — Gjithë bota me kalendar tē ri, ti me tē vjetrin. Çudi, si nuk ngatërröhesh?

HAXHIU — E pse do ngatërrohem? Pas hesapit tim, unë e kam më mirë nga tē gjithë. Dhe punët më venë grurë. A do më gjesh një kalendar sivjet, se po afron dhe viti i ri? Këtë më thuaj ti...

NAMIKU — Alla turka apo alla franga?

HAXHIU — Ah, sikur tē ma gjeje alla turka, edhe njëmijë lekë ta paguaja; po s'ka nga ata, e di mirë unë. Ma gjej alla frënga, pa e kthej vetë unë, si këtë që shikon këtu. Do mundohem ca, po s'ke ç'lë bën.

NAMIKU — Mirë, o xhaxha, do përpinqemi. (i nxittuar.) Sa mund tē ketë vajtur ora, se më shtatë kam një mbledhje.

HAXHIU — (Duke nxjerrë qostekun.) Dymbëdhjetë po vete...

NAMIKU — Sa, sa? Dymbëdhjetë! Pse kaqë shumë paskam ndenjtur unë këtu? (*i bie ballit. Shikon nga dritarja.*) Ç'na e hodhe, o xhaxha, dielli s'ka hyrë mirë, ti thua dymbëdhjetë! Varja maces atë orën tënde se s'bëka një para!

HAXHIU — I marrç të keqen sahatit tim. Ti e the vetë se dielli sapo hyn. E po ta dish, alla turka dielli perëndon gjithnjë më dymbëdhjetë. Të mbeti sahati? Vëre dymbëdhjetë kur hyn dielli; po gabove një minutë, më qafë time.

NAMIKU — E mora vesh; edhe sahati shkoka me kalendarin. Po mirë, alla franga sa i bie?

HAXHIU — Nuk e di, (*me ngulm*) nuk e di dhe nuk dua ta di!

P e r d j a

## TABLO E DYTË

Mensa e punëtorëve të gazit i përngjan një restoranti të vogël e të hijshëm. Në të djathëtë është banaku, kurse përballë sporteli, ku kuzhinieri shpërndan gjellën. Pranë banakut punëtorë dhe teknikë.

- Për të ngrënë ai është i vetmi.
- Nuk i ha dot, mos shit mend.
- I ha.
- Pesëdhjetë llokume të hash ti?
- Pesëdhjetë.
- Vëmë bast?
- Mos, se do humbësh bastin!
- S'ka gajle, le ta humbas.
- Me sa?
- Me sa të duash.
- Po i hëngra, më bëfshin mirë. Ti do të paguash paratë dhe u lamë.
- Po s'i hëngre?
- Atëhere do të paguaj unë 25 lekë dhe llokumet që tepërojnë...
- Me ujë apo pa ujë?
- Me një gotë ujë.
- Të ikën paratë, shoku inxhinier. Ky ha një derr të tërë e të mos hajë pesëdhjetë llokume?
- Nuk i ha dot se e velin. 50 llokume nga 50 gram i thonë dy kilogram e gjysëm peshë.
- Ai do t'i hajë dhe do zërë spitalin.

— Provoje po deshe.  
— Nxir edhe ti paratë, t'ia japid Spiros.  
— Ç'ke ti, paguaj llokumet njëherë!  
— Ah, posi, ditke mirë.  
— Ja, të paguaj unë dhe haji ti. Ti s'ha dot as pesë.

— Unë s'thashë që i ha. Spiro, sill llokumet këtu!

GUZHINIERI — (*Duke e hequr mënjanë*) Kurse unë di një sekret (*Njerëzit prësin*) Do të hash shumë llokume? Haji pa përtypur, se gryka velet, stomaku s'do t'ja dijë.

— Ah, komplot, komplot. Nuk e kemi ashtu. Spiro merri llokumet!

SPIRUA — Ngadalë se na çmendët!  
(*Te dera duket Haxhiu me Shegën përdore. Ai e tërheq si fëmijë.*)

HAXHIU — Tungjatjetani!

— Njatjeta. Njatjeta.

— Ka ardhur për ndonjë paketë cigare.

— Shiko si e tërheq.

(*Shega i tund dorën që t'ja lëshojë, ai kthen kokën dhe e qorton me sy.*)

HAXHIU — Ku është përgjegjësi?

— Spiro, të kërkojnë.

SPIRUA — Urdhëroni.

HAXHIU — More, më tha ai nipi im, Namiku, ndofta e njeh, të të takoj për atë punën që të ka folur.

SPIRUA — Vajza jote është kjo?

HAXHIU — E.

SPIRUA — Shumë mirë, atëhere mund të fillojë që tani nga puna. (*Shegës.*) Sa shkollë ke moj vajzë?

HAXHIU — Shtatë.

SHEGA — Të shtatën s'e kam mbaruar se... më... (*Shikon babanë*).

HAXHIU — E de, thuaje se u sëmure. U sëmur dhe pastaj mbeti prapa, kështu që e hoqëm.

SHEGA — Jo, unë... po...

HAXHIU — Vallë e bën dot? Mos është punë e rëndë.

SPIRUA — Pse jo? S'ka ndonjë punë të rëndë. Do të rrijë në banak dhe do të presë biletat me porositë e punëtoreve. Ditët e para do ta ndihmoj unë. (*Spirua e merr Shrgën dhë e fut brenda banakut. Haxhiu shikon rrëth e qark.*) Ti do të ulesh këtu. Ja lista e gjellëve, ja edhe çmimet. Vij unë dhe porosit: një pilaf, një mish me fasule, një kos. Ti i shënon të gjitha dhe pastaj i mbledh. Sa bëjnë?

SHEGA — Tridhjetë e tetë lekë.

SPIRUA — E ke gabim. Bëjnë tri lekë e tetëdhjetë qindarka.

SHEGA — (*Kafshon buzët*) Unë i bëra me të vjetrat.

SPIRUA — Këtu duhet me të rejat.

VEIZI — Një hesap është. Edhe neve me të vjetrat na vjen më mbarë, pa le ç'thotë Spirua. (*Haxhiut*) Babai i vajzës je ti?

HAXHIU — Si urdhëron, unë jam.

VEIZI — Po pse na shikon ashtu...?

HAXHIU — Jo, për perëndi.

VEIZI — More, lëre perëndinë atje ku është, po ti ashtu na pe...

HAXHIU — Jo, ore, kushedi si të është dukur.

VEIZI — Për vajzën ke merak ti? Të mos kesh hiç merak. Ne jemi klasë punëtore. Kush guxon të silit keq më vajzën tënde, ne i thyejmë brinjët. Ulu këtu! (*Haxhiu ulet.*) Ne i kemi sahanët pa kapak. Mos na shiko se jemi kështu ca të palarë e të parruar. I kemi familjet larg, po, kur kthehem nga shtëpitë, jemi si pëllumba. Edhe ne kemi vajza.

HAXHIU — (*Pa bindje.*) Jo, jo, nuk kam merak.

VEIZI — Ja, më shikon mua? Unë jam nga labëria, po kam 15 vjet që punoj në këtë ndërmarrje. Ne kemi shpuar puse në Patos, në Bubullimë, në Marinëz, në Goriçaj dhe tanë erdhëm këtu në zonën e Divjakës. Tek ne, edhe po erdhi njeriu i lig, do bëhet i mi-ri, se s'bën. Pse do të thuash ti. Se e tillë është puna dhe shoqëria.

— Shpjeri një raki fshatarësisë kooperativiste.  
(*Haxhiu shikon me habi gotën që i vjen përpara.*)

HAXHIU — Po kjo nga na erdhi?

VEIZI — Pije, a derëbardhë, e mos i bëj naze.

HAXHIU — Po dale, ta di nga kush e kam.

GAZMIRI — Pije, xhaxha, e ke nga klasa punëtore.

HAXHIU — Sot duhej t'ju qerasja unë.

GAZMIRI — Jemi shumë ne, nuk të del hesapi.

VEIZI — Do kemi rast të pimë herë tjetër, mos u bëj merak. E po me këmbë të mbarë!

HAXHIU — Falemnderit.

VEIZI — (*I afrohet e i bie me dorë në gjunjë.*) Po qe kismet, i gjejmë dhe ndonjë burrë këtej. Ne kemi djem xhevahirë. (*Haxhiu tkurret.*) Le që s'ka nevojë të mundohemi ne, se tani i gjejnë vetë. Apo e ke të fejuar?

HAXHIU — E po zëre si ta zësh...

VEIZI — Vetë e gjeti apo e fejove ti?

HAXHIU — Ja, ashtu, ca unë ca ajo...

VEIZI — Mirë, mirë. Ne tani do ikim se fillojmë turnin. Do na falësh.

HAXHIU — Nuk më the si të quajnë.

GAZMIRI — «Skodë». (*Haxhiu e shikon me habi*)

VEIZI — Veiz më quajnë. Veiz Çika po doçeria më thérresin «Skodë», se jam ca si bina e madhe. Po ty?

HAXHIU — Haxhi, Haxhi Hasa.

VEIZI — Gëzohem. E po mirë u pafshim, Haxhi! (*Ngrihet e vete pranë Gazmirit.*)

GAZMIRI — Ja gjete zemrën më duket. Sa shpejt i zë miqtë, more Veiz! I çuditshëm je!

VEIZI — Folë me zemër të hapur dhe do kesh plot miq!

GAZMIRI — Veç kur i the në e kish të fejuar vajzë, nuk i pëlqeu. E vure re si u struk?

VEIZI — Po më duket se s'të paska pëlqyer as ty! Mos ki frikë se nuk mbetesh pa martuar!

(*Ata dalin nga skena. Namiku hyn*)

NAMIKU — E, xhaxha, si tē duket këtu?

HAXHIU — Qënkekëshin tamam burra këta! Dhe namuslinj. Ishte një Veiz, Veiz nga Labëria.

NAMIKU — U, «Skoda»!

HAXHIU — Burrë i mirë. I kish lezet fjala. Atë do ta thérresim edhe pér darkë, kur tē kemi ndonjë rast.

NAMIKU — E di ku punojnë ata xhaxha? Te ai pusi afër shtëpisë sonë, te nënta.

HAXHIU — Kështu si fytyra i kam parë, më ngjan. Disa nga këta na ndihmuani atë ditë, kur na mori zjarr depua e grurit prej rrufesë. Dhe u vërvitën në zjarr si tē ishte gruri i tyre. Të mos ishin ndodhur këta, do ta kishim patur pisk.

NAMIKU — Në punë njihet njeriu, xhaxha.

HAXHIU — Në punë d'he në bukë. Si ka tēngrë-nët, ashtu ka edhe punën.

NAMIKU — Këtë s'e kisha dëgjuar.

HAXHIU — Ja, e dëgjove tani. Im atë gjithmonë ihoshte: Ai njeri qé ha bukë shpejt, edhe punën e ka tē shpejtë.

NAMIKU — Kjo nuk mund tē jetë fare e vërtetë. Varet nga gjellët. Po t'i kesh gjellët tē buta, i ha shpejt; nga uria, nga... edukata.

HAXHIU — Ato janë pesë me hiç. Më ke vënë re mua si ha bukë? Në pesë minuta, kam borxh tē mbaroj, sikur tē jem edhe në gasti. Pse më do brigadieri mua? Se i bëj punën. 460 ditë pune futa vitin e kaluar dhe megjithatë kryetari nuk më nxori tē dalluar.

NAMIKU — Mirë ta bëri. Pér punë je i vetmi ti, po ç'e do që ke ca huqe tē tjera. Pse nuk e le Shegën tē merrte pjesë në grupin artistik?

HAXHIU — A! Ashtu oprri-uprri nuk dua unë. Dhe që s'më nxori tē dalluar, nuk m'u prish puna; unë gesenë e mbusha.

NAMIKU — C'do t'i bësh gjithë ato para, o xhaxha?

HAXHIU — Dasma do harxhe, s'do llafe. Një çu-

pë ka Haxhiu dhe do ta djegë, kur i thonë fjalës.

NAMIKU — Ngrihemë tani, o xhaxha?

HAXHIU — Ngrihemë. Këtë muaj jemi kënaqur se po vjelim rrush. (*Bën me shenjë sikur ha.*) Pse s'del ndonjë ditë andej nga vreshta?

NAMIKU — Ka rrush pazari plot. Me dy lekë merr një kile.

HAXHIU — Tjetër lezet ka në vreshtë. Mua më pëlqen «Hafiz Aliu», ka edhe émrin të mirë. (*Shegës.*) Në darkë do vij të marr, këtu të më presësh.

SHEGA — Mirë, baba.

HAXHIU — E po njatjetani!

SPIRUA — Mirë ardhsh.

(*Ndërkohë që ata nisen të dalin, hyn përsëri Sika Gjini — tekniqe laborante në zonën e shpimit.*)

SIKA — Ou, na paska ardhur një kuadro e re. Shoku Spiro, si i ke punët? Ku do vesh të punosh tashti?

SPIRUA — Në prodhim.

SIKA — Në kuzhinë?

SPIRUA — Në pus, zanatin që kisha, sondist...

SIKA — Shiko, puno mirë, o i zi, se mos të të zë-vëndësojnë edhe atje me ndonjë grua. (*I drejtohet Shegës.* Të njihemi. Më quajnë Sika Gjini — Po juve?)

SHEGA — (*Pak e hutuar.*) Shegë.

SIKA — Shiko, Shegë, (*I prek shaminë që ka në kokë*) Si i thoni ju kësaj?

SHEGA — Shami.

SIKA — Në disa vende i thonë çember. Po sikur ta heqësh, prishet gjë? (*Ja heq*) Ja, kështu dukesh edhe më e bukur.

SHEGA — Mos është turp të rrish pa shami?

SIKA — Aspak. Ne të gjitha kështu rrrimë. Në vend të shamsë mund të vesh një kordelë. Të pëlqen kjo imja? (*Ja vë në kokë*) Tani, shoku Spiro, mund të porositim?

SPIRUA — Jemi gati t'ju shërbejmë.

Një grup punëtorësh para banakut ku shërben Shega. Ajo ka ndryshuar shumë, është e çlirët, e shkathët dhe e vetëdijshme.

— Pesë dopio konjakë, pesë llokume.

GAZMIRI — (Duke iu afruar grupit të punëtorëve.) C'ka ngjarë? Si është puna?

— Kemi festë. A do të pish?

GAZMIRI — Kush po fejohet?

— Fituan flamurin. Brigada jonë arriti shpim rekord. 450 m. shpim brenda një muaji.

GAZMIRI — E kush paguan?

— C'të duhet ty se kush paguan. A do të pish? Mbushi dhe një Gazmirit.

(Duke treguar me gisht një çunak)

— Braçes mos i jepni.

— Pse të mos i japim? E kemi antar të brigadës.

— Ka munguar tre ditë, prandaj këtij nuk i takon t'ja mbushësh plot. (Ja pi çerekun e gotës.)

BRAÇJA — Ej, ej.

— Ka munguar me arësyte.

— Ta dish ti, o i zi, se ku ka qenë ky ato tre ditë...

— A, vërtet?

— Te nusja, ore, te nusja.

— Prandaj të thërriten me telegram urgjent?

BRAÇJA — Po.

— Pse, si qe puna?

BRAÇJA — Ajo e fejuara ime qe shkruar vullnëtare për në hekurudhë dhe më datën një duhesht të nisej. Mirëpo, prindërit e mij, s'e kishin lënë. Ata i kishin thënë: Si do shkosh në hekurudhë pa lejën e të fejuarit? Dhe për këtë shkak më thërriten mua urgjent me telegram. C'kam hequr gjithë asaj nate duke udhëtuar, unë e di. Vajta në shtëpi duke u dredhur, prisnja

19763

17

56602

të gjeja ndonjë të vdekur, se telegram urgjent. Kur i shikoj, ishin të gjithë mirë. Si është puna? i pyeta. Kështu e kështu, më tha nëna. — Mirë, se ia rregulloj unë qejfin asaj, thashë dhe menjëherë u ngrita në këmbë. Ashtu o bir, më tha nëna — mblidhja një çikë se është tërbuar fare. Aty unë e në shtëpi të krushkut. — Brenda është Sofia, se Sofi e quajnë. — Brenda, më tha vjehra. — Thuaj një çikë të vijë këtu. Pas pak doli ajo me sytë përdhe. — Kishe vendosur të shkoje në hekurudhë? — Po, më tha. — E pse nuk shkove dje me shoqet e tjera? Ata të tjerët po dëgjonin prapa derës. — Nga shkaku i familjes tënde... më tha dhe filloj të qante. — Pika që s'të bie, i thashë, pse, me të qara ndërtohet socializmi? Hajde, merr plaçkat dhe vishu. Dhe një të marrë për krahu, një ta shpënë në hekurudhë.

— Po mirë, drejt në hekurudhë e shpure? Nuk qëndrove hiç në ndonjë qoshe?

BRAÇJA — Hmë! Ku të vete mendja.  
(*Punëtorët qeshin me të madhe*)

GUZHINIERI — Tavë me kos edhe dy racione ka.  
Dëgjove Shegë?

SHEGA — Dëgjova.

(*Bisedë në një tryezë*)

SIKA — Ti mos shit mend se ti je martuar vetë me mblesëri.

— Ashtu ishte koha atëhere. Të isha beqar tani, pa të më shikoje.

— Ç'komunist është ai që e shet të bijën me para. Je në vete ti?

SIKA — Dhe pastaj shkon në konferencë dhe flet për të drejtat e grave.

— Hakën.

SIKA — Dhe kur kthehet nga konferenca vë të shoqen t'i lajë këmbët.

— Ajo e këmbëve nuk është dhe aq e keqe. Sa të flesh me këmbë të palara, më mirë t'i lajë gruaja a çupa.

SIKA — Shumë e keqe është dhe shumë poshtë-ronjëse. Fytyrën a e lan vetë. Po, vetë. Po atëhere, pse mos lajë dhe këmbët?

— Ja, unë nga fshati jam, po këmbët i kam larë gjithmonë vetë.

SIKA — Këtu në kantier po, se s'do të vij unë ti laj këmbët e tua.

— Jo, jo, edhe kur kam qenë në fshat.

— A keni prift në fshat?

— Jo.

— Pse s'vete të bëhesh ti, me atë mjekër që ke lënë nuk e ke të vështirë.

— Tridhjet e gjashtë orë s'kam luajtur nga pusi unë, se kishim avari. I shikon duart e mia?

— Ç'më duhen duart, unë shikoj mjekrën. Mbaje, mbaje, në mos të ngjitshim ndonjë fletë rrufe, do të kapim si diversant.

— Nuk kam as brisk. Ata «miefistot» nuk bëjnë një grosh.

— Brisqe të jap sa të duash (*fut dorën në xhep*) Urdhëro një pako.

— Këta po. Këta janë të mirë. Falemnderit. Sa bëjnë?

— Në dyqan shitën me para.

(*Përpara banakut*)

VEIZI — Një makaronë me salcë, një mish me spinaq, një kabuni (*shokut që ka pranë*) E marrim dhe nga një teke?

— Më mirë e lëmë për në darkë.

VEIZI — Si të duash. E kështu, që të kam fjalën, pajë nuk dëgjoi të merrte. Mirë moj çupë, i thashë unë, po edhe neve na vjen turp të dalësh nga shtëpia lakuriq. Ne do të të bëjmë aq sa kemi fuqi. «Jo baba, më tha, unë kam shkollë, kam diplomë, a ka pajë më të mirë se kjo? Dhe kish të drejtë. Ta shikosh tani, si e ka rregulluar apartamentin, të luan mendja e kokës.

SPIRUA — Ka pasur të shoqin të mirë ajo. Të kesh ndonjë si ai dhëndërri im dhe eja të merresh

vesh pastaj. Kërkon edhe garderob. Unë s'kam garderobë pér vete.

(*Në tryezë*)

— Sidoqoftë ti e ke motër.

SPIRUA — Motra ime është në institut. Ai vjen e më thotë mua. Për atë motrën tënde interesohet filani. Është djale i mirë, i pashëm, drejtor shkolle, një vëlla e ka kryeinshinier, etj. Prandaj në se s'kini ndonjë kundërshtim, është një rast shumë i mirë. Dëgjo, i thashë unë, në rast se ajo motra ime, që është në shkollë, nuk është e zonja të martohet vetë, të gjejë në jetë atë që do, atëherë më mirë të mos martohet. Ai m'u zemërua. E ke kot që zemërohesh; i thashë, di unë se motra nuk dashuron ndonjë tjetër?

— Ti duhet t'ja kiske thënë motrës.

— Jo. Unë mbles i motrës nuk bëhem. Po sikur ajo të ma presë: Ore vëlla, në ç'shekull jeton ti? Si t'i thosha unë?

(*Në një tryezë tjetër*)

— Ke qënë ti te 542-shi?

— Kam qenë.

— Atë ditë që e shuam?

— Atë ditë që të nxora nga argjili tok me Veizin. Mezi të shkulëm si pras.

— Për pak u mybyta atë ditë. Dhe do isha harruar tani.

— Bah, në asnje mënyrë. Do t'i vinim pusit emrin tënd.

— Po 542-shi s'ka qenë asgjë në krahasim me katrën bis. Dilte gazi me presion 300 atmosfera dhe, mos harro, ne e myllëm brenda dy ditëve. Nga katra e kam këtë kujtim.

(*I tregon një shenjë në ballë.*)

— E, ç'bëje ti te katra? Shkarkoje çimento pesë-qind metra larg dhe tani na shet mend.

— Atje ku isha unë ti s'qëndroje dot dy orë. Në grykë të pusit! Pastaj një muaj nuk dëgjoja fare nga veshët.

— Si ishte ajo botë pa veshë?

— Nuk ishte keq. Nja dy muaj shpëtova dhe nga mbledhjet dhe nga kritikat. Lereni Shyqon, thoshin, se nuk dëgjon. Po pastaj ma punuan. Që të më provonin në dëgjoja, më shanin prapa krahëve. Unë ktheja kokën, ata qeshnin. Ka hair nga ca si ky? (*Tregon me dorë Gazmirlin, i cili atë çast hyn me një tufë letra*).

GAZMIRI — Posta, shokë, posta. (*U vjen rrrotull nëpër klub me tufën e letrave në dorë duke kënduar këngën e postierit. Hipën në një fron.*) Kolë Huta, mensa e zonës së shpiimit. Letra vjen nga Bik Huta. Çfarë e ke këtë Bikun, djalë apo baba?

KOLA — Bjere letrën këtu, s'ka ç'të duhet ty.

GAZMIRI — (*të cilit s'i pëlqen serioziteti*) Shegë, jepi pak ujë t'i ftohet motori. Për nder, po s'ma the ç'e ke Bikun, s'ta jap letrën.

VEIZI — (*me dialekt*) Thuaje, a derëzi, se s'u bë qameti.

KOLA — Ja them, po druej se s'po më za besë.

VEIZI — Po t'i rrëfesh të drejtën, pse jo?

KOLA — Të drejtën, pasha sytë e ballit.

GAZMIRI — Thuaje.

KOLA — Bikun e kam krushk.

GAZMIRI — Me një mbiemër? Na gënjeve, më duket...

KOLA — Jo, për nder, se baba i tij asht martue me nanën time.

GAZMIRI — Si, si, si? Baba yt me nanën e tij... po atëhere... (*Qeshin të gjithë*).

— Ta hodhi.

— Bukur për nder.

— Ja edhe këtë s'e kisha dëgjuar.

GAZMIRI — Krushk. Kjo duhet mbajtur mend. Veiz Çika. Dërgon Kadife Çika. O dreq! O Veiz, nga plaka e ke? Unë e di se ç'të shkruan. Ja ngreua, eja vetë, ja dërgo ca para se ato të parat ikën. Ndërtuam një oxhak të ri se na kreu tymi sytë.

VEIZI — Ta merr mendja, kam një muaj pa vajtur te plaka.

GAZMIRI — Na, kur t'i shkruash, i bëj të fala.

VEIZI — Nga ti?

GAZMIRI — Jo nga unë, nga shoqëria. E kam parë në fotografi plakën tënde. S'hahet as me hudhër.

VEIZI — I marrsh të keqen plakës sime. Kur ish e re, qe si sorkadhe.

GAZMIRI — Sorkadhe me çitjane.

VEIZI — Unë kam djalin kaq sa ti, o i zi.

GAZMIRI — O Janis Apostolidhis! Pu ise, more qeratadhesh?

— Mungon, ka turnin më duket.

(Flet me aksent)

GAZMIRI — Nuk este këtu, ka skuar me serbimi to Gjirokastra, me kërkesa të krietaryt. Kalla, kalla! Spiro Devolliu.

SPIRUA — Këtu.

GAZMIRI — P.U. Letra s'ka pullë, të vjen nga vëllai që e ke ushtar. S'besoj të ketë ndërmarrje tjetër në rrethin tonë që të marrë letra nga kaq krahina të ndryshme sa kjo jona.

SHEGA — S'ke letra të tjera?

GAZMIRI — Kam gazeta.

SHEGA — Unë të pyes për letra.

GAZMIRI — Po pse, gazeta s'është letër? Vetëm se këtë e shkruajnë shumë njerëz. Ti a e lexon gazeten?

SHEGA — Ndonjëherë në të rrallë.

GAZMIRI — Gabim. Duhet ta lexosh.

SHEGA — Atje ka ca gjëra që s'i kuptoj fare. Dëgjo: Konvejeri i gjelbër, hallkë e rëndësishme për shtimin e prodhimit të qumështit dhe të nënprodukteve të tij. C'është ky konvejer i gjelbër, s'e marr vesh, po me siguri duhet të jetë diçka e lyer me bojë jeshile.

KUZHINIERI — Mishi me spinaq mbaroi. Tani ka rosto, kim me vezë dhe ato kontornot e tjera.

— Sot na ke kënaqur, xha Arif.

KUZHINIERI — Falemnderit, është detyra jonë.

— Po të të them një gjë, veç mos të mbetet hatëri. Ke filluar të plakesh.

KUZHINIERI — Jo, për nder jam i fortë. Unë shtrydh domaten e frigoriferit.

— Dëgjo këtu, sa është njeriu i ri e ka mendjen te dashuria, kur plaket te gjellët.

— Po ti, xha Arif?

KUZHINIERI — Aha, ika edhe unë. E di atë vjershën plak, ashik edhe tapall? Dëgjoje. (*Fillon ta recitojë*)

Dale moj se kam një fjalë,  
Dale moj se jam i çalë...

GAZMIRI — Shiko, Shegë, do të të pyes një gjë, po këtë herë seriozisht.

SHEGA — Nuk të shkon serioziteti ty.

GAZMIRI — (*E shikon me habi sepse nuk e priste një gjë të tillë nga Shega*) U çele, më duket.

SHEGA — Ti vetë më the se, duke punuar këtu, do të ndryshoheshë.

GAZMIRI — Po e di që ke marrë pamje tjetër?

SHEGA — Rri tashti, lëri ato fjalë.

GAZMIRI — E kam seriozisht.

SHEGA — Po ta kesh seriozisht, drejtohu në familje.

GAZMIRI — Ohu! A të kujtohet në fillim si të sillte babai për dore, si një fëmijë që e shpie në klasë të parë? (*e imiton*). Pastaj rrinte këtu dhe ndizte një cigare.

SHEGA — Po që atëherë kanë shkuan shtatë muaj.

GAZMIRI — Mos të të vijë keq, po atë babanë e ke turqi.

SHEGA — Këto shtatë muaj kanë qenë për mua si një shkollë. Ditë për ditë kam mësuar gjëra të reja. Ju silleni ndryshe, gjykoni ndryshe, nuk di dhe aqë mirë si ta shfaq...

GAZMIRI — Po si, në ç'mënyrë?

SHEGA — Ku di unë, jini më të hapur, më të sin-qertë dhe...

GAZMIRI — Ta merr mendja, jemi klasë punëtore.

SHEGA — Edhe unë e ndjej që kam ndryshuar pak.

GAZMIRI — Veç jo aqë sa duhet.

SHEGA — Përse e ke fjalën?

GAZMIRI — E kupton vetë ti, ah, ç'je një ti!

SHEGA — Hajde, ç'kishe pér të më pyetur? Jo, jo, nuk dua të më pyesësh.

GAZMIRI — Po ku e di ti se ç'do të pyes unë?

SHEGA — E di unë, se ti kurdoherë ashtu më pyet. Nuk dua të më ngacmosh, lermë në hallet e mia. Unë a të ngas ty?

GAZMIRI — Edhe ti më ngjet mua.

SHEGA — Unë të ngas ty? Ç'na the...

GAZMIRI — Ja, bile edhe këtë çast po më ngjet.

SHEGA — Mos luajte? Me se po të ngas unë?

GAZMIRI — Me sy. Kur më vështron ti...

SHEGA — Oh, lëre, lëre...

GAZMIRI — Bile edhe ty ta ka qejfi kur të ngac-  
moj unë.

SHEGA — (*duke hapur sytë.*) A! ç'flet, more!

GAZMIRI — Po, po, mos e moho. Tregoju e sin-  
gertë.

SHEGA — Uh, aman se po pëlcas.

më fole ti e para?

SHEGA — Unë të fola? Nuk më kujtohet mua...

GAZMIRI — Nuk erdha këtu në banak dhe po rri-  
ja pa folur? Ti më pyete: «Po ti Gazmir ç'do të ma-  
rrësh»?

SHEGA — Të pyeta pér çështje pune, siç i pyes  
të gjithë.

GAZMIRI — Mirë, po edhe mund të mos më  
kishe pyetur. Dhe përveç kësaj ti pastaj queshe.

SHEGA — Po nga të mos qeshja? Unë të pyeta  
çdo, ti u përgjegje «shtatë syltjaçe»! Ha njeriu shtatë  
syltjaçe në një vakt?

GAZMIRI — Atë ditë e kisha stomakun pak si

të vrarë. Jo vetëm stomakun, por edhe zemrën. Dhe duhej ta zbusja pak.

SHEGA — Dhe ta zbuti syltjaçi.

GAZMIRI — E po lidhen të gjitha bashkë, sultjaçi, buzëqeshja jote, etj, etj.

SHEGA — Uh, sa i marrë! Hajde, ç'kishe për të pyetur.

GAZMIRI — Që të ka fejuar ytë atë pa të pyetur, këtë e di. Po desha të të pyes në shpreson të shkosh jetë të mirë me atë.

SHEGA — (ngre supet.) Nuk e di.

GAZMIRI — Po mirë, si është ai i fejuarit yt? Zeshkan, bjond, i gjatë, i shkurtër?

SHEGA — Nuk e di.

GAZMIRI — Pse, nuk e ke parë ndonjëherë?

SHEGA — Jo.

GAZMIRI — Vërtet s'e ke parë asnjëherë?

SHEGA — Ti kërkon të tallesh, më duket.

GAZMIRI — Kjo po më habit.

(Hyn Shero Nareci, një burrë i imtë dhe pak gërmuq)

SHERUA — (Duke u hedhur një vështrim të djalëzuar) Shegë, ti qenke këtu, moj çupë?

SHEGA — Unë jam, xha Shero.

SHERUA — Një paqetë desha unë. Do më japësh?

SHEGA — Po si jo, xha Shero, me gjithë qejf. «Partizani» e do?

SHERUA — Si të jetë. (Gazmirit.) Se më kanë thënë që ky dyqan është vetëm për punëtorët.

GAZMIRI — Po s'ka gjë, o xhaxho, ne s'do kur sejmë duhanin. Kur kemi ne, kini dhe ju dhe kur kini ju kemi dhe ne.

SHERUA — Mirë, mirë, mirë. (Shegës) Babai këtu është?

SHEGA — Në shtëpi e lashë.

SHERUA — Vajta në shtëpi po nuk e gjeta; do vij gjene në darkë.

SHEGA — Mirë.

SHERUA — (*duke dalë*) Thuaji një çikë të kërkonte Shero ag... (*Shikon Gazmirin.*) Shero Nareci (*del.*)

GAZMIRI — Po sikur të jetë ndonjë si ky?

SHEGA — (*Me frikë*) Uuu! Unë vdes dhe nuk e marr.

GAZMIRI — E ku e di ti se si është, deri sa nuk e ke parë?

SHEGA — Babai s'do më fejonte me një si ky.

GAZMIRI — Babai ty të ka shitur, dhe thua se ke mësuar nga klasa punëtore. Hiç, asgjë s'ke mësuar, kur lë të tjerët të marrin nëpër këmbë jetën tënde.

SHEGA — Po ç'mund të bëj unë? Të gjitha vajzat në fshatin tonë kështu janë fejuar.

GAZMIRI — Ti që jeton këtu midis nesh, duhet të bëhen shembull edhe pér ato. Shiko, Shegë, ç'ki she pér të thënë ti sikur unë të të thosha... Të të thosha... (*Shega pret pa frymë*)

GAZMIRI — (*me ton tjetër*) Nëm një gotë raki!

SHEGA — (*Çlirohet. I mbush gotën dhe ja vë mbi banak.*) Urdhëro.

GAZMIRI — (*Duke e kthyer fund*) Ç'kishe pér të thënë ti sikur unë të të thosha, po këtë herë seriozisht ama... të të thosha... (*me ton tjetër*) Nëm edhe një gotë verë!

SHEGA — Urdhëro edhe verën. Këtë kishe pér të thënë me aqë zor?

GAZMIRI — Jo, jo, ato i piva pér të marrë guxim. Tani do ta them. (*kollitet.*) Pse nuk ndahesh nga ai? Pse nuk tregohesh e guximshme?

SHEGA — Kollaj të duket ty?

GAZMIRI — Çudi, ti nuk jeton fare me kohën. Nuk je hiç revolucionare, më duket mua...

SHEGA — Pse?

GAZMIRI — Nuk shikon se ç'bëhet në vendin tonë. Me qindra vajza nga malësia në hekurudhë lanë të fejuarit qysh në djep.

SHEGA — Ato e kanë më lehtë, kurse unë...

GAZMIRI — Ti duhet të jesh e para që t'i thyesh zakonet prapanike dhe paragjykimet në fshat. Shëmbullin tënd me siguri do ta ndjekin edhe të tjerat.

SHEGA — Për mua është vonë, Gazmir, unë për dy-tre javë martohem.

GAZMIRI — Si?

SHEGA — Ata kërkuan një njeri të ndanin ditën e martesës dhe babai meqë s'vente dot vetë, se që i sëmuarë, do dërgojë Namikun. Dhe sot Namiku duhet të niset.

GAZMIRI — Atëhere unë i paskam rënë legenit kot.

SHEGA — Në fillim mua kjo fejesë më dukej një gjë krejt e natyrshme, sepse edhe nëna ime, edhe shqet në fshat kështu qenë fejuar. Vetëm kur fillova të punoj këtu, zakonet filluan të më rëndonin dhe i shikoja me tjetër sy. U thoshja edhe shoqeve, ato që dëgjoja e shikoja këtu dhe ato ju njohin juve që të gjithëve.

GAZMIRI — Sa interesant! Po më përparrë nuk e ndjeje peshën e zakoneve?

SHEGA — Jo, nuk e ndjeja, se ishim rritur me to. Pastaj kur dëgjova dhe fjalimin...

GAZMIRI — Po babait s'i ke thënë ndonjëherë?

SHEGA — Uh! Ku fjalos dot me babanë tim. Ai është ashtu si the ti, turqi. Kur vij këtu, jam e qeshur dhe e mësuar, sepse i tillë është «ambienti», apo s'i thonë kështu?

GAZMIRI — Ashtu i thonë.

SHEGA — Po kur shkoj në shtëpi, bëj punë e qaj fshehurazi.

GAZMIRI — Ti s'e ke vetë të qartë atë që kërkon.

SHEGA — Unë e kam shumë të qartë. Nuk dua të martohem me një njeri që s'e njoh. Nuk dua, nuk dua!

GAZMIRI — Po atëhere pse të qash? Vendos dhe mbaroi.

SHEGA — Ashtu të duket ty? Unë jam bërë si e shushatur, s'di nga t'ja mbaj.

GAZMIRI — E po atëhere, s'të ka faj njeri. Bëj si

të duash. Veç një gjë dua të të them: ti... ti... ti... :  
(Me tjetër ton.) fjalosemi pastaj.

(Matet të iki me vrull. Ndërkohë hyn Sika.)

SIKA — Ej, karabush. Nuk sillet kështu me vajzat.

GAZMIRI — Lérna, për kokën tënde.

SIKA — Aj, pa ta tregoj qejfin në mbledhje.  
(Shegës) Ç'pati? Tani s'ka filluar as vapa mirë.

SHEGA — U nxeh me mua?

SIKA — Me ty? — Më jep një shkrepse! — Po  
pse, ç'pati?

SHEGA — Ta dish Sika, jam në hall të madh.  
Gjumi natën nuk më zë.

SIKA — Atëhere, duket se fle ditën.

SHEGA — Ti kërkon të bësh shaka. Aman Sika,  
më thuaj si të bëj. Po afron dita që të martohem.

SIKA — Uh, sa mirë, si lumë ti!

SHEGA — Si të bëj?

SIKA — Njashtu pra, si kanë bërë të gjitha.

SHEGA — Uff! Po unë s'dua të martohem, s'dua!

SIKA — Pse moj, e ke marrë me frikë?

SHEGA — Dëgjomë të lutem...

SIKA — Dëgjo edhe ti. Kur më puthi Fatmiri për  
herë të parë, m'u ndezën faqet prush, m'u errësua bo-  
ta dhe për pak më pushoi zemra. Po pastaj mësohesh...

SHEGA — Po ti, ti more atë që deshe.

SIKA — (Serioze.) Ta merr mendja! Pse ti kë do  
marrësh, atë që s'do?

SHEGA — Po ti e di, mua më kanë fejuar pri-  
ndërit...

SIKA — (Me habi) Pse atë do marrësh? Je në vete  
ti? Unë thashë se mos bënim ndonjë dasmë këtu...

SHEGA — Këtë po më thoshte edhe Gazmiri

SIKA — Shumë mirë të paska thënë.

SHEGA — Dhe tani jam në hall. Në qoftë se mar-

tohem, e di që do nxij jetën time. Do mar një burrë që as e njoh, as më njeh. Çfarë jete do shkoj me të? Në goftë se nuk e marr dhe bëhem unë shkakëtare, atëherë duhet të mos i dal babait përpara syve.

SIKA — Njëra nga të dyja. Kompromise s'ka këtu. Ose qejfi yt, ose i babait.

SHEGA — Pa mendo pak. Unë vetëm atë baba kam në botë. Nëna më la jetime dhe ai nuk u martua së dyti që të mos më bënte me njerkë. Tani si të veproj unë? Më dukej sikur dita e martesës nuk do vinte kurrë. Edhe ndonjëherë që më kujtohej, unë e largoja nga koka këtë mendim. Po ja tani dita po afrohet dhe unë me dikë duhet të ndahem. Kujt t'ja prish, zemrës apo babait?

SIKA — Babait.

SHEGA — Uh, sa lehtë e thua ti!

SIKA — Zemrës mos ja prish se me atë s'i rregullon dot punët, kurse me babanë ndryshon puna.

SHEGA — (E pushton.) Uf, Sika, më çlirove. Sikur më hoqe një perde nga koka. Do vij përsëri në laborator të bisedojmë.

SIKA — Tani pasdite do jem në dhomë. Më përpara kristë dyfeku, dhe përsëri kish vajza që merrnin atë që donin e jo sot që ke në krahë partinë, pushtetin, shoqërinë. Hiç, moj, mos e merr!

SHEGA — Si t'i them babait, kësaj s'ja gjej dot anën.

SIKA — Do ta rregullojmë dhe atë punë. Ne do të të përkrahim, kooperativa po ashtu, se s'jemi në kohën e baba Qemos.

SHEGA — Mirëpo puna nuk pret. Ata po nxithen. Kanë dërguar lajm pér të ndarë ditën e martesës...

SIKA — Ah! E paskan ndjerë frikën...

SHEGA — Dhe babai, meqë s'vete dot vetë se éshtë si pa qejf, do dërgojë Namikun.

SIKA — Ja rregulloj unë Namikut, veç mos më daltë përpara.

(*Hyn Namiku.*)

NAMIKU — Oh, q'u lodha!

SIKA — Hajde, hajde!

NAMIKU — (*Ulet.*) Xhaxhai s'ka ardhur akoma?

SHEGA — Unë as që e di në do të vijë.

NAMIKU — Posi, më tha ta pres këtu në ora nëntë.

SIKA — Shpejt qenke kujtuar, tani ora po vete tre pasdite.

NAMIKU — Tamam në kohë paskam ardhur se xhaxhai e mban orën alla turka. Xhaxhai të gjitha hesapet i ka me të vjetërën, edhe lekët, edhe orën, edhe kalendarin...

SIKA — E, po si, e përfunduat?

NAMIKU — Lërmë aman, se jam në një telash të madh. Mu në dreq është ajo Sulova. As makina s'vete në fshatin e tyre.

SIKA — Ore Namik, po si s'të vjen turp?

NAMIKU — Pse moj shoqe?

SIKA — Je dhe rini, pale.

NAMIKU — S'po të marr vesh.

SIKA — Ti s'meriton të jesh fare në organizatë.

NAMIKU — (*Ngrihet në këmbë. Serioz*) Pse shoqja Sika, q'paskam bërë?

SIKA — Po më të bësh akoma? Aleancë me zakenet prapanike dhe me mbeturinat mikroborgjeze. Në vend ta ndihmosh tët kushrirë të dalë nga kjo gjendje, ti vete pret ditën e martesës.

NAMIKU — Aaa! Për ndër, djersë të ftohta po më bijen, sikur po vete të zbuloj varrin e babait. Më ka lezet mua të shkoj e të pres ditën e martesës? Kurse xaxhai thotë: ty të takon!... hej bela!

SHEGA — E ta dish, që unë s'martohem atje, ti koi po vete.

NAMIKU — Kur e paske vendosur këtë gjë?

SHEGA — Sot.

NAMIKU — Të lumtë, të lumtë, se më shpëtovë dhe mua. Le që më vriste ndërgjegjja, po do haja dhe një kritikë të mirë. Atëhere t'i themi xhaxhait dhe mbaroi puna.

SHEGA — Thuaja ti.

NAMIKU — Unë dhe Nasi i kemi thënë njëqind herë, po ati s'i mbushet koka. Sot ja thuaj ti.

SHEGA — Uh, e zeza unë.

SIKA — Nuk merr vesh me të thënë ai, ne duhet të veprojmë me ndonjë farë mënyre dhe ta ndihmojmë Shegën.

NAMIKU — Dakord jam unë.

SIKA — Puna është që kjo martesë të mos bëhet këto ditë.

NAMIKU — E si ta ndihmojmë?

SIKA — Sajo diçka, ty sikur të pjell mendja.

NAMIKU — E gjete! Ku kam mënd unë? Ju e kini mendjen femër dhe u pjell.

SIKA — Po sikur të bëhet e sëmurë?

NAMIKU — S'pyesin ata, e marrin dhe të sëmurë. Eja, se të shëron dhëndërri, i thonë.

SIKA — Më duket se e gjeta. Nga një anë më mirë që vete ti kjo do na ndihmojë shumë. Po sikur të bisedosh me djalin? Ja thuaj copë. Atëhere...

NAMIKU — Ai, po të ish nga ata djem, e kish bërrë vetë atë punë. Kurse ai mezi pret të marrë një copë nuse. E njoh, e njoh...

SHEGA — O këto zakone të poshtra!

SIKA — Ti the se xhaxhai ecën me kalendarin e vjetër.

NAMIKU — Po... Prit pak... Hopa! Po sikur, sikur...

SIKA — Çfarë sikur?

NAMIKU — Sikur të ngatërrojmë datat?...

SIKA — Si? Në ç'mënyrë?

NAMIKU — Po ja pra, njërit alla frëngë, tjetrit alla turka, që të mos merren vesh. (duke vënë duart në kokë) Obobo, ç'do vejë. (Fillojnë të kërcejnë nga

*gëzimi*). Po ku të futem nga xhaxhai pastaj?

SHEGA — Ti thuaj ku di gjë unë, kështu e mora vesh.

NAMIKU — E pastaj?

SIKA — Dhe pastaj me siguri krushqit do ikin të zemëruar dhe do ta prishin fejesën. Atëhere Shega shpëton. Në qoftë se na dështon ky plan, do të ndërhyjmë ndryshe, do të gjejmë dhe rrugë tjetër.

NAMIKU — Aman veç ejani dhe ju atë ditë, ti, Veizi, Spirua, Gazmiri, se ndryshe është puna po të ndodheni dhe ju.

SIKA — Mos ki merak. E gjithë brigada e pusit nëntë, atje do të jetë.

SHEGA — Unë atë ditë nuk do rri fare në shtëpi.

SIKA — Ashtu e bëj, eja të rrimë bashkë këtu.

GUZHINIERI — Shegë moj çupë, eja të spontojmë ato kuponat.

SHEGA — Ja, një minutë sa të mbledh. (*Del*).

NAMIKU — Oh, ç'ka për të vajtur!

HAXHIU — (*duke hyrë*) Këtu qënke, o Namik?

NAMIKU — Këtu, o xhaxha, po të pre sipas fjalës dhe sipas orës. Sa e ke orën?

HAXHIU — Do edhe dy minuta pa të vejë nëntë. (*Sikës*) Si je ti, moj Sikë?

SIKA — Mrekulli, xhaxha. Ti si vete? Shega më tha sikur ishe pa qejf.

HAXHIU — Kam një artrit këtu në gju. Kur pri-shet koha, më shtrëngon. Unë e ndjej përparrë se të pri-shet koha, bile. Po ai pusi juaj si duket? Do nxjerrë gjë apo...

SIKA — Të shohim.

HAXHIU — Shqencë thoni ju, po me ç'shikoj unë, edhe ju më tym ecni. E ku dini ju se ç'ka toka poshtë?

SIKA — Se nuk e dimë, prandaj kërkojmë.

HAXHIU — E, e, mirë e ke. (*Namikut*) Kur do nisesh asaj Sulove?

NAMIKU — Kur të duash ti, Xhaxha.

HAXHIU — Shiko, tē rrish i tapinosur, fjalët tē pakta dhe me mend, se je krushk.

NAMIKU — Mirë, o xhaxha.

HAXHIU — Jo mirë, por dëgjo këtu. Sa dolli tē ngrenë ata pér ne, aqë do tē ngresh edhe ti pér ata. Po i pinë ata me fund, do ti pish edhe ti, se kështu e do zakoni.

NAMIKU — Kam frikë se bëhem tapë.

HAXHIU — Jo tapë, po kërcu tē bëhesh. Zakoni éshëtë zakon.

NAMIKU — Unë do t'u them kam raport nga mjeku dhe s'e pi rakinë fare.

HAXHIU — Po e bëre këtë, më mirë mos shko. Po e di unë që s'e turpëron xhaxhanë ti. Krushkut Femi, krushkut tē madh, do t'i bësh veçanërisht tē fala nga unë. Dhe sytë jo andej-këtej, dhe kur tē flasë ai, ta shikosh në gojë.

NAMIKU — Dakord.

HAXHIU — Dhe buzëvarur tē mos rrish, po edhe shakara pa kripë tē mos bësh.

NAMIKU — Uffff!

HAXHIU — Jo uf e puf, po mos harro që je në këmbë time.

NAMIKU — Si urdhëron. Do t'i kem parasysh tē gjitha deri sa tē jem esëll!

HAXHIU — Ashtu më rrofsh! Si? Ç'është ajo fjalë sa tē jem esëll? Të pish rakinë, jo mendtë.

NAMIKU — Këtë herë nuk e mbajte fjalën o xhaxha.

HAXHIU — Unë? Unë s'di tē dal nga fjala.

NAMIKU — The se dasmën do ta bëjmë kur tē dalë buka e re, po ja, nuk e prite grurin e ri.

HAXHIU — S'ka gjë, edhe me grurë tē vjetër nuk prish punë. Pastaj ne s'kemi gjë në dorë, janë ata që urdhërojnë, ana e djalit.

NAMIKU — Njësoj i kemi tē drejtat.

HAXHIU — Zakoni nuk thotë ashtu. Për dasmën,

do t'u thuash kur të dëshironi, veç brenda muajit prill.  
Në maj jo, në asnje mënyrë.

SIKA — Pse?

HAXHIU — Është gjynah. Ata që martohen në  
maj s'bëjnë kurrë prokopi.

NAMIKU — Edhe këtë do ta kem parasysh.

HAXHIU — Më trofsh o nipçe e më dasmë tënde  
t'i shpërblefsha këto ndere.

NAMIKU — S'ka gjë xhaxha, e kemi për detyrë  
t'i ndihmojmë rinisë.

## FUND I AKTIT TË PARË

## AKTI I DYTË

Shtëpia e Haxhiut. Ka ardhur pranvera dhe një degë kumbulle e lulëzuar është zgjatur në dritare. Haxhiu peshon vozat me verë e raki.

HAXHIU — Njeriu i mirë dallohet nga katër gjëra. Edhe i ligu nga katër.

I MIRI: nga sjellja e mirë, nga ndërgjegjja, nga idheja e lartë, nga fjala. I ligu: nga tahmaqarillëku, nga aseti, nga inati, nga kokëmadhëria.

NAMIKU — Domethënë, po ta ketë kokën të madhe....

HAXHIU — Kokëmadhëria ose hundëlartësia, me një fjalë qibra, e kuptove tashti? Unë me cilësitë që kam, hyj në të mirët.

NAMIKU — Po unë?

HAXHIU — Pyet veten tënde, mos më pyet mua.

NAMIKU — Më fal për sinqeritetin, xhaxha, por as ti nuk hyn në njerëzit e mirë.

HAXHIU — e pse, ç'ke pikasur ti tek unë?

NAMIKU — Me gjithë ato mbeturina që ke ti si mund të hysh në njerëzit e mirë?

HAXHIU — Unë jam më i përparuari në fshat. Të gjithë të folën kur ti i vure bulldozerin minaresë së xhamisë, vetëm unë s'të thashë gjë dhe u gëzova.

NAMIKU — E di unë pse u gëzove ti, se ishe zë-në me hoxhën pér pemët e xhamisë. Ti doje t'i bashkoje me kopshtin tënd, kurse ai doli më i zgjuar, ja shiti të vëllait nën dorë.

HAXHIU — Edhe këtë e paski marrë vesh?

NAMIKU — Po ç'kujton ti?

HAXHIU — Megjithatë burri lidhet nga fjala, hajvani nga kapistalli. Kur ishim një herë, në pazar të Lushnjës e kisha nxjerrë një lopë pér ta shitur, vjen një çoban dhe më pyet: «Sa i thua?» Unë doja t'i kérkoja njëzet e tetëmijë, po më shpëtoi goja dhe i thashë njëzet e dy. «Sa?» më pyeti pak i habitur se thalopa, e drejt e fjalës, ish e mirë. «Njëzet e tetë, i tha-

shë unë, se fola gabim». «Burri një herë flet», tha ai. «Merre, i thashë unë, mua më shpëtoi goja, po merre». «Bravo», më tha ai «se ti qenke tamam burrë». Kështu që thua ti, nipçe, humba gjashtëmijë lekë, po fitova një nder më të madh dhe fjalën nuk e hëngra.

NAMIKU — Ta ka hedhur, xhaxha. Populli thotë burri kthen, muri nuk kthen.

HAXHIU — Ndonjë si ti, po. Unë gjer tani nuk i kam turpëruar këto mustaqe. Dhe nuk do t'i turpëroj, në dashtë zoti, gjersa të vdes.

NAMIKU — Xhaxha, them të mbaj edhe unë mustaqe, Ti si më këshillon?

HAXHIU — Të mendohem.

NAMIKU — Kaq i vështirë qenka problemi?

HAXHIU — More nipçe, janë mustaqe ato, nuk janë lesh mbi buzë. Po mbajte mustaqe, duhet të shkurtosh gjuhën, të mos pish, të mos dehesh, të mos rrish me njerëz dosido.

NAMIKU — E përse gjithë këto kondita?

HAXHIU — Ta merr mendja. Se po t'i shau ai tjetri mustaqet, me nder teje, atëhere ç'i do fare. Ose preji e hidhi, ose shko mbytu në det.

(Vjen Shega për të mbledhur filxhanet e kafesë.)  
Eja dhe ti dëgjo këtu.

SHEGA — Urdhéro, baba!

HAXHIU — Që të bëhesh fis, duhen tre breza, që të bëhesh stërfis nuk duhen as tre, orë. Ç'domethënë?

NAMIKU — (Ngre supet.) Kjo është si gjézat e sfinksit.

HAXHIU — Mos u nxito. Po bëra unë një marrëzi, le që mua s'më mbetet sy e faqe të dal ndër njerëz, po edhe për tim bir kështu do thonë. I mirë pyet. Edhe për nipin kështu do thonë. Xhevahir djalë eshtë filani, po q'e do, ka pasur një baba që lere mos e nga. Kështu që duhen tre breza që të bëhesh përsëri fis. Prandaj, (ngre gishtin) ta kini mendjen në kokë.

NAMIKU — Dardha nën dardhë do bjerë, o xhaxha.

HAXHIU — Ashtu vërtet, po mos harro se nga ferra del trëndafili dhe nga trëndafili del ferra.

SHEGA — Baba, unë gjer tashti s'ta kam prishur ndonjëherë.

HAXHIU — Të më dëgjosh, pos, se të kam bërë kokën.

NAMIKU — Të dëgjosh dhe të bindesh janë dy gjëra të ndryshme.

HAXHIU — E kam fjalën për atje ku do vesh, se tani po afron dhe dita e martesës, ja pas dy jave — unë nuk do të jem atje, po emri im atje është. Po u solle mirë, do thonë e kemi nusen të mirë, po u solle keq, do ma hedhin fajin mua. S'ka faj kjo, do thonë, kështu e ka mësuar i ati. Kështu që do të turpërosh veten tënde dhe mua. Pse? Se unë e bëra atë krushqi.

NAMIKU — Prandaj është më mirë kur martohen me dashuri. Atëhere e kanë vetë përgjegjësinë.

HAXHIU — Atë fjalë të mos e zësh ngoje në shtëpinë time.

NAMIKU — Pse?

HAXHIU — Se zuzarët martohen me dashuri.

NAMIKU — Këtu e shkele, xhaxha. Kjo tregon edhe një herë se ti nuk ecën me kohën. Mblesërisë iiku koha...

HAXHIU — Po ç'më shet mend ti mua! Mblesëria s'ka asgjë të keqe. Hë, ta fejosh që në djep, po, ashtu është gabim, po kur çupa bëhet sa një pelë, atëhere s'ke si ta mbash në shtëpi.

NAMIKU — Njësoj është, deri sa e fejon pa e pyetur.

HAXHIU — Po pse, ore nipçe, ta pyesësh kot? Ka ndonjë çupë që të thotë s'dua të martohem?

NAMIKU — Po mbasë ajo s'do atë, do një tjetër.

HAXHIU — Burrë, ore, burrë të jetë. E di unë ku e ke hallin ti, po mua s'ma hedh dot. (*Shegës.*) Ikë andej matanë ti, shko preqatit ca ujë dhe eja të më lash këmbët.

NAMIKU — Pse nuk i lan vetë këmbët?

HAXHIU — (*i kafshohet Namikut. Shega dël.*) Ka nja dy muaj që nuk po m'i lan këmbët. Gjen ca mari-fete, njëherë fut duart në brumë, njëherë i vete orari, po e kuptoj që s'do të m'i lajë. Ma bënë ujet gati dhe pastaj ikën. Kjo t'u lajë këmbët atje ku do vejë? S'më besohet. Do më turpërojë. Zakonet duhen respektuar.

NAMIKU — Për cilat zakone e ke fjalën?

HAXHIU — Për të gjitha.

NAMIKU — Ehu, sa punë më duhet mua që të të edukoj ty...

HAXHIU — Çfarë të më bësh mua?

NAMIKU — Të të edukoj.

HAXHIU — Pa mos të marr këtë bisht fshese e të të futem me të, sa të të duket prifti gomar. U bëre ti të më mësosh mua!

NAMIKU — Jo unë. Këtë e kanë thënë ca më të mëdhenj nga unë. Ne kemi zakone të mira, kemi dhe zakone të këqia. Të këqiat do t'i shërbim, fiu, si minaren e xhamisë dhe do t'i shkelim me këmbë.

HAXHIU — Jalla, koka jote! (*Ndihen disa këmbë dhe menjëherë hyjnë Veiz Çika, Gazmir Struga dhe Spiro Devolliu.*)

VEIZI — Ç'bën, o Haxhi, si vete?

HAXHIU — E si të vete? Pyetën një plak njëherë: Pse ke dërsitur? Se po fjalosesha me një djalë, u përgjegj. Edhe mua ashtu më gjeti. Po uluni, zini vend.

SPIRUA — Jo, Haxhi, nuk do rrimë shumë. Ne sapo mbaruan turnin dhe u kthyem të pimë nga një ujë të ftohtë.

HAXHIU — Ju lumçin këmbët. Në shtëpinë time të vini pa druatje, kurdoherë goftë.

GAZMIRI — Sikur të kemi shqetësuar si shumë, sidomos me pusin e ujit.

HAXHIU — As mos e thuaj atë fjalë, ne jemi fqinj.

VEIZI — (*mënjanë Namikut.*) Po vijnë krushqit. (*Namiku kërcen përpjetë dhe kërkon si të shpëtojë.*)

NAMIKU — Unë po iki, xhaxha.

HAXHIU — (*autoritar.*) Jo, jo, rri aty.

NAMIKU — Kam ca punë pér të bërë.

HAXHIU — Rri aty tē them. E di unë që e ke ditë pushimi sot. I hedh fjalët llap e llup e tani kérkon tē ikësh. Do ta zgjidhim atë punën e mbeturinave. Dëgjo, Veiz, se ti je më i pjekur.

GAZMIRI — (*mënjanë Veizit*) Shega éshtë më mirë tē mos ndodhet këtu.

VEIZI — Urdhëro?

HAXHIU — (*Namikut*) Ti i ke shokë, unë i kam miq. Si ta ndajnë këta, ashtu le tē jetë.

VEIZI — Po Shegën këtu e ke, o Haxhi, apo iku në punë?

HAXHIU — Këtu éshtë.

GAZMIRI — Ajo duhet tē vejë në mensë se kanë ardhur disa shokë pér tē bërë inventar. Sa pér Nami-kun, këtu e kemi.

HAXHIU — Më pérpara le tē bëjë kafetë, pastaj tē ikë.

VEIZI — Jo, a derëbardhë, se kafenë e pimë një-herë tjetër.

HAXHIU — S'bëhet deti kos, pér pesë minuta.

GAZMIRI — E di si éshtë puna, Haxhi? Ata po e presin në këmbë, se s'kanë as çelësat. Sikur s'ka lezet tē lëmë tre burra tē presin.

HAXHIU — Mirë, vetëm puna tē mos prishet. Ti, Namik, ulu aty.

VEIZI — E po si e kishit atë punë?

HAXHIU — Ty do tē tē bëjmë kadi. Ulu aty dhe thuaj kush ka tē drejtë, se unë tē njoh pér burrë tē drejtë dhe namuslli.

NAMIKU — Nuk lejohet t'i bësh lajka gjykatësit.

(*Shega duket më një gjym e një legen*)

SPIRUA — Shegë, po tē presin në mensë. Nisu shpejt!

SHEGA — Ja, tani do ikë. Baba, ujët dhe legenin pér tē larë këmbët e ke këtu.

HAXHIU — (*Duke murmuritur*) Mirë, mirë. (*Namikut.*) E pe?

VEIZI — Atëhere fillojmë.

HAXHIU — Ky nipçja thotë pér mua se kam 'mbeturina borgjeze. Unë mbeturina nuk kam, këtë e di mirë, si një e një që bëjnë dy.

NAMIKU — (*Me vete*) Obobo ç'do më gjejnë këtu!

HAXHIU — Si the?

NAMIKU — Thashë do ta gjejmë këtu.

HAXHIU — Do ta gjejmë, posi.

NAMIKU — A nuk i mbron ti të gjitha zakonet?

HAXHIU — A, këtu po. Unë i mbroj zakonet dhe i dua. Pse do të thuash ti? Sepse zakonet janë më të lashta se ligjet. Është apo s'është kështu?

VEIZI — (*Shikon nga Gazmiri. Gazmiri tund kokën në shenjë pohimi.*) Ke të drejtë.

HAXHIU — (*Namikut.*) E shikon?

NAMIKU — Pikërisht se janë më të vjetra prandaj nuk vlejnjë. Po qe se do të mjaftonin zakonet, njerëzit e zgjuar nuk nxirrnin ligje. Pra ligjet janë një hap përpara.

VEIZI — (*shikon përsëri nga Gazmiri. Ai pohon.*) Ke të drejtë.

NAMIKU — (*Haxhiut.*) E shikon?

HAXHIU — Zakoni ëstë më i fortë se ligji? Pse? Sepse ligjet ca i njohin, ca s'i njohin, kurse zakonet i dinë të gjithë dhe trashëgohen brez pas brezi.

VEIZI — (*Gazmiri përsëri pohon.*) Ke të drejtë.

HAXHIU — (*Namikut.*) Dëgjoje!

NAMIKU — Ligji është më i fortë se zakoni. Po shkele një zakon s'të dënon njeri, kurse po shkele lligjin, dënimin e ke prapa.

VEIZI — (*Gazmiri i bën shenjë të thotë «po».*) Edhe ti ke të drejtë.

NAMIKU — (*Haxhiut*) Dëgjoje!

HAXHIU — (*proteston.*) Jo, jo, s'ka hiç të drejtë. Po shkele zakonin, turpërohesh pér jetë të jetëve. Dhe turpi është më i rëndë se dënimini.

VEIZI — (*Gazmiri pohon.*) Ke të drejtë, asantu është.

HAXHIU — Ashtu, tē lumtē goja. (*Namikut*) E dëgjove?

NAMIKU — Kjo varet si tē jenë zakonet. Ja, tē marrim zakonin e tē fejuarit tē vajzave qysh nē djep. Ata që e shkelën këtë zakon, u turpëruan nē sy tē njerëzve apo u nderuan? U nderuan. Atëhere, kush shkel zakonin nderohet.

VEIZI — (*Gazmiri pohon.*) Edhe ti ke tē drejtë.

HAXHIU — Ore vëlla, ç'është kështu, se s'po marrim vesh gjë... Ti duhet tē na e shkoqësh punën se s'të vumë kot plak, e jo ke tē drejtë njërit ke tē drejtë tjetrit.

VEIZI — Për nder, as unë s'po marr vesh kush ka tē drejtë. Një gjë di unë, o Haxhi se edëe zakonet s'kanë zbritur nga qielli, njerëzit i kanë bërë. Duam a s'duam ne, disa zakone do ndryshojnë se kështu ka ardhur koha. Nuk di këtej nga anët tuaja, po andej nga anët tonë kemi pasur një zakon tē poshtër. Po tē nise shin krushqit pér nuse, nuk mund tē ktheheshin pa nuse nē shtëpi. Mirëpo qëlloi që nusja vdiq atë ditë që po martohej, aqë e pati, atëhere krushqit muarën motrën e saj, që ishte akoma kalama dhe ikën. Zakon m'i thua këtij?

SPIRUA — Po pse ai zakoni tjetër që, kur vdiste vëllai i madh, nusen ta merrte vëllai i vogël? Kam njobur unë një Luto, Luto; i cili mbeti pa martuar e thoshte: «Ç'të marto hem, ja do vdesë vëllai dhe do marr nusen e tij». Ai vëllai i tij ishte plak në mykët, edhe i sëmurë, mirëpo pér tē vdekur nuk vdiste. E prit sot e prit mot, shkuan pesëmbëdhjetë vjet, gjersa një ditë...

VEIZI — Vdiq i vëllai.

SPIRUA — Ç'ne o, vdiq Lutua se i vëllai rron akoma.

SHERUA — Aty je, o Haxhi?

HAXHIU — Këtu, këtu. Ajde, Shero aga.

SHERUA — Si vini, si shkon, a jini mirë?

VEIZI — Falem nderit. Ti si shkon, si mbahesh?

SHERUA — Si të shkoj, njeri pa grua. Jetim...

HAXHIU — (*Gjoja duke i qarë hallin.*) Ah, ç'e ka gjetur këtë të ziun! Ka mbetur qyq.

VEIZI — Pse, beqar është akoma?

HAXHIU — Tri herë është martuar...

GAZMIRI — Dhe s'ka asnje?

HAXHIU — Dy i kanë vdekur, kurse e treta i iku. Është hapur fjala se këtij s'i rrojnë gratë, prandaj i iku kjo e treta.

SHERUA — Ç't'i bësh. Fati...

NAMIKU — Hiq dorë, more Sheri, se u bëre gazi i botës...

SHERUA — Pse, ore, ç'ka këtu për të qeshur?

NAMIKU — S'je për martesë ti tashti.

SHERUA — Pse, ore, si të dukem unë? O po ky, ore!

NAMIKU — Je plak...

SHERUA — Unë plak, unë që s'kam mbushur gjashtëdhjetë vjeç?

NAMIKU — E pse, mos të ëndket vetja i ri?

SHERUA — Shiko se ç'thotë. Po gruaja për pleqëri duhet, more Namik. Kur je i ri bën edhe pa grua, kur plakesh s'bën dot.

GAZMIRI — Kur plakesh s'bën dot, mirë e ke.

VEIZI — Duhet për pleqëri, të të shtypë nga pak, të të ndrysjëj, të të lajë këmbët, rrrobat...

SHERUA — Hë më rrofsh!

VEIZI — Ç'ke në shtëpi?

SHERUA — Të gjitha të mirat. Lopë, dele, gomar. Vetëm një copë grua...

VEIZI — Unë të pyes për fëmijë.

SHERUA — Jo, fëmijë s'kam. (*Haxhiut.*) Tani vetëm tek ti e kam shpresën. Për para mos më kurse, i kam mbledhur dhe i ruaj në një vend të fshehtë. Si u bë puna e asaj vejushës? Hë?

VEIZI — Nuk do i ati.

SHERUA — Po pse, ore, pse të mos dojë... Sa ta mbajë ai në shtëpi kot, e mbaj unë...

HAXHIU — E po s'deshi, ç't'i bëjmë? Mbase ka dhënë fjälën gjetkë.

SHERUA — Oh, Ç'na bëri! Te kjo, më thosh një mendje që do mbarohej puna, po ja, s'm'u bë gjë. Pçë, pçë! Aman Haxhi, shiko pér ndonjë vend tjetër se ty tē shkon fjala. Le tē jetë ca si e shkuar, le tē jetë dhe me fëmijë, s'ka gjë.

VEIZI — Veç grua tē jetë...

SHERUA — Hë! Duhet pér pleqëri... Aman Haxhi, tani ti e ke në dorë se tē tjerët s'më dëgjojnë (del.)

VEIZI — Ç'është ky?

HAXHIU — O ç'më ka gjetur mua me këtë qy-qar! Po pinim njëherë në klub dhe unë me tē qeshur i thashë: «Shero aga vetëm unë ta di hallin ty se jam vetë pa grua, pa nga këta tē tjerët mos prit se s'i ke pér gjë. Unë do tē ta mbaroj hallin». Dhe që atëhere më është qepur e s'më ndahet. Tri herë në javë më vjen në shtëpi.

NAMIKU — Preja shkurt; ç'e mban zvarur?

HAXHIU — Më vjen dhe keq pér tē shkretin.

NAMIKU — Xhaxha, t'u ftoh ujët.

HAXHIU — Do më ndjeni sa tē laj pak këmbët. Ti, Namik, mbaji me muhabet, se miku në dimër do zjarr dhe muhabet, kurse në verë muhabet dhe ujë tē ftohtë.

(*Del në dhomën tjetër*)

NAMIKU — Ore, si shumë u vonuan ata, Ku i pe ti?

VEIZI — Ne po vinim me maqinë, ata me kuaj. Duket do kenë qëndruar në anë tē fshatit sa tē kre-hin baluket.

(*Ndihet një këngë dasme.*)

«Shtro shtëpinë e nis shtëpinë,  
moj gjeraqinë,

Se krushqitë po tē vijnë,  
O moj gjeraqinë»

NAMIKU — Unë po iki, tē mos më gjejnë këtu se s'dihet si do t'i dalë fundi kësaj pune. (del).

VEIZI — E ç'do vejë. . .

(*Kënga ndihet më afër.*)

Mir'ja bëmë krushkut-o,  
q'i muarmë të bijën-o,  
atë më të mirën-o.

HAXHIU — (*duke dalë zbatbur, me pantallona tē shpërvjela e me pecetën që ka fshirë këmbët në dorë.*)  
Ore, ç'janë këta krushq; ku bëhet kjo dasmë?

VEIZI — Ku ta dish.

HAXHIU — Po këta sikur po kthehen këtu? O!

GAZMIRI — Nuk besoj. Mos kanë ngatërruar shtëpinë. . .

HAXHIU — U, u, u, po vijnë. . .

(*Krushqit afrohen duke kënduar. Dy prej tyre hyjnë në dhomë. Haxhiu i shikon me habi.*)

FEMIU — Mirëse tē gjejmë, o krushku i madh!

— Këtej sikur s'bie fare erë dasmë. . .

FEMIU — Ore krushk, më njeh apo s'më njeh?

HAXHIU — Si, ore, s'të njoh, ti je krushku. . . Je ti krushku Femi, apo jam gabim?

FEMIU — Unë jam dhe sa një derr.

HAXHIU — E po ç'e mirë ju solli?

MURATI — Kjo e mirë na sjelltë ngahera e përtë tilla ardhshim. (*duke u kthyer nga ana ku po shtyhen tē hyjnë te dera.*) Prisni, burra, mos u ngutni. (*Haxhiut.*) Po këtej nga ju sikur s'shikojmë gjë. Ç'farë ka ngjarë?

HAXHIU — Jo, ore, në rregull jemi ne, lavdi zotit!

MURATI — Njerëzit e shtëpisë i ke tē gjithë shëndoshë?

HAXHIU — Si molla. . .

MURATI — Shyqyr! Kjo ka rëndësi! Po ndonjë vdekje në fis a në miqësi, se helbete njerëz jemi. . .

HAXHIU — Jo, s'di gjë.

MURATI — Po atëhere ç'ka ngjarë?!

HAXHIU — (*me interesim.*) Pse, ç'ka ngjarë? Hiç, asgjë.

FEMIU — Unë s'po kuptoj gjë...

HAXHIU — As unë.

MURATI — Po mirë, si është puna, ju paski vendosur të mos bëni dasmë?

HAXHIU — Si jo? Dasmë dhe dasmë të madhe, bile. Haxhi Hasa një çupë ka! Po ju për ku jini nisur?

MURATI — (*qesh*) Aha! Qenke shakaxhi, o krushk!

FEMIU — Ne jemi nisur të marrim nuse.

HAXHIU — Ku kështu?

MURATI — Ja, këtu, në fshatin tuaj.

HAXHIU — Te kush?

MURATI — Te Haxhi Hasa!

HAXHIU — A!

MURATI — Pse habitesh?

HAXHIU — Po kështu pa lajmëruar fare vihet te krushku?

FEMIU — Pse pa lajmëruar? A nuk u muarëm vesh tre javë përpëra?

HAXHIU — Tamam ashtu.

FEMIU — E po atëhere?

HAXHIU — (*duke i mbyllur synë*) Pse erdhët përpëra ju... Si e kini hallin? Kini marrë vesh gjë? Hë, për këto mblesëritë...

MURATI — Ne kemi ardhur sipas fjalës.

HAXHIU — (*duke i vënë dorën përpëra.*) Jo, më paç uratën, dasmën e kemi për dy javë.

FEMIU — (*Bërtet.*) Fjalën e kishim për më gjashtëmbëdhjetë.

HAXHIU — Tamam ashtu!

MURATI — A nuk është gjashtëmbëdhjetë sot?

HAXHIU — Jo, sot kemi tre. Do edhe trembëdhjetë ditë... Thamë më gjashtëmbëdhjetë allaturka, jo allafranga.

FEMIU — Ne u muarëm vesh allafranga.

MURATI — Le të vijë këtu Namiku!

HAXHIU — (*duke u kthyer.*) Namik, eja këtu. Ku është, more, ku u fut? Ai këtu sikur qe. O Namik! Pa eja këtu të merremi vesh! O-o-o-o ç'qenkemi marrë vesh.

(*Pecetën që ka në dorë e hedh në qafë si peshqir.*)

MURATI — Atëhere të hyjmë apo të mos hyjmë?

HAXHIU — Urdhëroni, shtëpia ime është e hapur.

GAZMIRI — Një minutë, sa të mbathë çorapet.

HAXHIU — Po, vërtet, se jam kështu. (*Nxjerr çorapet nga xhepi dhe i mbath.*) Mos u mérzitni, burra, se të gjitha rregullohen.

FEMIU — Këta shokët nga i kemi?

VEIZI — Ne jemi punëtorë në këtë pusin këtu. U kthyem t'i bëjmë një vizitë Haxhiut.

GAZMIRI — Ama ditë e bukur sot. Andej nga ju si ishte 'moti?

MURATI — Tani, burra, u bë si u bë, këtu duket që ka një ngatërresë. Ne nuk do rrjmë ta zgjidhim se s'ja kemi ngenë. Jemi krushq dhe kemi ardhur për dasmë. Në qoftë se ti s'bën dasmë, kjo është puna jote, qejfi yt...

HAXHIU — Kush tha që s'kam qejf të bëj dasmë?

MURATI — Prit, të mbaroj unë një herë, se fjalëni e kemi ne. Dhe ne urdhërojmë. Ti na jep tani nga një raki sa për urim, na jep nusen ta hipim në kalë dhe mbeç me shëndet. Të tjerat pastaj i zgjidhím më vonë...

HAXHIU — Si, ore?

MURATI — E po ne nuk do rrimë të bëjmë givq për kalendarët. Gjithë bota me kalendar të ri, ti me të vjetrin.

HAXHIU — Shiko, në je krushk, rri si krushk dhe hyqme në shtëpinë time mos bëj! (*fshin buzët me pecetën që ka në qafë, pastaj kujtohet dhë pështyn.*) Në e mbaj sahatin allaturka a allafranga, kjo është punë për mua dhe ty s'të duhet.

FEMIU — Ngadalë, burra, se s'ju ka hije.

— Ne kemi ardhur tē pimë e tē këndojojmë se martojmë Yzedinin. Merrja një herë, o Sulo. Iso, more, iso! (*Sulua te dera ja merr këngës.*)

FEMIU — E po si do bëjmë, o krushk?

MURATI — Do marrim nusen dhe do ikim.

HAXHIU — C'nuse, ore?

MURATI — Nusen tonë.

VEIZI — Me lejë? Më duket se s'ka nevojë tē bërtisni.

HAXHIU — Mirë thotë ky shoku, se na dëgjojnë dhe bota.

MURATI — Ne pér këtë punë kemi ardhur. Zako-ni e do që tē mos kthehemë pa nuse në shtëpi.

HAXHIU — Po zakoni thotë që çupa nxirret nga shtëpia me dasëm.

FEMIU — Rri o krushk, mos na pengo!

HAXHIU — Jo more, se s'e kam çupën tē vje-dhur që ta nxjerr nga shtëpia fshehur.

FEMIU — Tani s'është koha pér fjalë, ti e kuption.

HAXHIU — E kam iritur me njëmijë mundime.

Unë këtë ditë do gëzoj.

FEMIU — Duhet irregulluar kjo punë.

HAXHIU — Ashtu, tē lumtë goja. Ta rregullojmë.

FEMIU — Puna është, që mishi tē piqet dhe helli tē mos digjet.

HAXHIU — Kur s'ka zi, bëhet dasmë. Kështu thotë zakoni dhe unë dua tē bëj dasmë.

MURATI — Shumë mirë, ashtu duam dhe ne.

Thërrit miqësinë dhe mbaroi puna.

VEIZI — (*Më nj'anë*) Ai qenka shumë i shkathët.

GAZMIRI — (*më nja'në*) Do jetë mblesi.

HAXHIU — Ashtu po. Ti ke mbledhur miqtë e tu, pa shiko sa mirë. Unë pse tē mos i mbledh tē mitë?

MURATI — Mblidhi edhe ti...

FEMIU — Tamam, fjalë me vend.

HAXHIU — Ja, u muarëm vesh, kaqë ishte puna...

MURATI — Atëhere dërgo një njeri, tē vijnë kë-

tu ata miqtë e tu, t'ja marrim dy-tre herë këngës, të urohemë dhe të nisemi, se jemi pér rrugë.

HAXHIU — E kur ta bëi këtë punë?

MURATI — Sot.

HAXHIU — Bah, sot s'bëhet kjo punë. Unë kam miq të largët, po dajallarët, mbesat. Po nipin që e kam ushtar? Të mos jetë ai këtu?

FEMIU — (*Diç fjalos me Muratin në vesh.*) Atëhere, o krush, e lëmë pér nesër. Ne sonte ja shtrojmë këtu sipas zakonit, do harxhohesh ca, po s'ke ç'i bën.

GAZMIRI — Si zor ta mbarojë Shega inventarin.

HAXHIU — Jo, jo, s'bëhemë dot hazër pér nesër. S'pyes unë pér inventar, kam hallin e zakoneve. Po zakoni thotë, të shoshet gruri, të gatuhet brumi, të hidhet kënaja, të hapet paja. Kur do t'i bëj unë këto?...

FEMIU — Léri ato tashti...

HAXHIU — Krushku Femi, ç'më thua kështu? Unë imansëz nuk bëhem, se jam burrë zakoni.

MURATI — Ne s'kemi si të vijmë dy herë... Dhëndrrri po pret.

FEMIU — E po hallit si i bëhet?

HAXHIU — S'kemi ç'bëjmë, do presim pér më gjashtëmbëdhjetë.

MURATI — Je burrë me mustaqe, Haxhi, dhe s'duhet të fjalosesh si fëmijë. Do na e japësh çupën apo jo?

HAXHIU — (*me qetësi.*) Çupën? Çupa është juaja. Unë s'di të kthej fjalë.

MURATI — Në është jona, na e jep.

HAXHIU — (*i lodhur.*) Nuk e kam gati, daç besoni, daç, jo. Ajo po shet bukë në dyqan.

VEIZI — Dëgjoni, o miq, të them edhe unë dy fjalë me që u ndodha këtu. Ju kini të drejtë, sepse zakoni e do që të mos ktheheni pa nuse në shtëpi. Edhe ne andej nga anët tona kështu e kemi pasur...

MURATI — Ashtu, pos!

FEMIU — Shumë mirë. Ke folur si burrë.

VEIZI — Po edhe Haxhiu ka të drejtë. Duhet t'i

thërresë miqtë edhe ky, sepse pérndryshe ata do t'i zemérohen. Siç ka vajtur ky ka njomur lugën në shtëpi të tyre, do vinë edhe ata këtu. Borxhe janë këto. Aqë më tepër që ky dasmë tjetër s'ka pér të bëré. Ja, men-dojeni pakë, sikur kjo gjë të ngjiste në shtëpinë tuaj.

(Heshtje.)

GAZMIRI — Ju i bini rrangalles kot, që të dy palët. Jo zakoni kështu, jo zakoni ashtu. Me sa kuptoj unë, kjo është një çështje thjesht personale, domethë-në private. Ç'kini ju? Lereni të merret vesh dhëndrri me nusen...

MURATI — Dhëndrri ynë është në shtëpi.

VEIZI — Oh, po ju s'qenkeni fare në terezi. Ku vini në dasmë pa dhëndërr! Andej nga malësia, shkruan gazeta, po s'erdhi dhëndrri, nuk ja japid nusen. Edhe kryesia jonë...

— Ore ti shoku atje! Mos na hidh degë më degë. Ç'hyn këtu kryesia?

— Ne nuk martohemi me kooperativën!

MURATI — Mjaft, mjaft. (Haxhiut.) Thuaj fjalën e fundit po a jo.

HAXHIU — Ejani pas dy javë, sipas fjalës. Unë këtë di.

FEMIU — Oh, i shkreti unë ç'u turpërova! Mori fund nderi dhe shtëpia ime. Si të kthehem pa nuse në shtëpi, a e mendoni pak?! Më mirë të më bjerë pika, dambllaja këtë çast, më mirë të mos e kisha arritur këtë ditë. Po harxhet, po miqtë që presin, si t'u dal pérpara? (bie në tokë.)

MURATI — (krenar.) Ngreu, Femi, se s'të ka lezet... Mbaje veten!

FEMIU — Si t'i dal djalit pérpara? Unë nuk vij me ju, nuk kam si të vij! Më tregoni pusin, pusin...

VEIZI — Jepini katruvën.

(Gazmiri i shpi, Femiut katruven. Ai e shikon me habi dhe pastaj e shtyn tej.)

FEMIU — Oh, i shkreti unë, u bëra me turp!

MURATI — Femi, s'të ka lezet nä shtëpi të krushkut. Eja 'me mua. Ngjau c'ngjau, burrat dinë të merrn vesh. Eja, Femi, të fjalosemi (*E merr Femiun dhe të dy dalin përjashta, pranë tufës me kallame. Në skenë bisedojnë vetëm me gjeste.*)

MURATI — Femi, të kam ditur burrë!

FEMIU — Iku burrëria, Murat. Mua mos më numëro më burrë. Gjemë një dyfek, pa e di unë se ç'bëj, ose vramë 'mua. Burri për një ndër rron.

MURATI — (*patetik.*) Femi! Të dua të mirën. Unë do të ta shpëtoj nderin.

FEMIU — Aman, kë do vrasësh?...

MURATI — Krushkun. Haxhi Hasën.

FEMIU — (*e përqafon.*) Më shpëtovë, Murat, më shpëtovë.

MURATI — Po nuk do ta vras 'me plumb. (*Femiu mërzitet.*) Dëgjo. Krushku na e punoi. U muar vesh. Po edhe ne do t'ja lajmë hakën. Do ta bëjmë që të flasë me vete dhe të mos ketë faqe të dalë ndër shokë. Do t'ja ndyjmë mustaqet.

FEMIU — Aman!

MURATI — Do të bëjmë gjoja sikur s'na mbetet hatëri dhe do t'i themi se do të vijmë pas dy jave (*ulët.*) Po ne nuk do vijmë. Dhe nusja e nisur do t'i mbetet në derë... A-ha-ha! A ka turp më të madh se ky?

Brez pas brezi do të kujtohet; i 'mbeti çupa në derë, do thonë...

FEMIU — Phë! (*tund kokën dhe përdredh buzët.*)

MURATI — Nuk të pëlqen?

FEMIU — Murat, më mbetet djali pa nuse... Kur turpërohem unë, ç'më duhet për botën?

MURATI — Ti nuk do turpërohesh. E kam zgjidhur dhe atë punë.

FEMIU — Aman, si?

MURATI — Ne do të vemi sot te një miku im, andej nga ana jonë dhe do t'i marrim çupën. Kështu që ne nuk do kthehem pa nuse në shtëpi.

FEMIU — A na e jep pa?

MURATI — Ka mbaruar ajo punë. Unë ta bëra këtë krushqi, unë do ta bëj dhe atë tjetër. Çupën e ka të mirë, veç që është memece. Po kështu nga pamja, nga puna, nga sjellja s'ka të sharë...

FEMIU — Po...

MURATI — Pa më thuaj, ç'e do nusen me gojë, apo të dëgjosh fjalë? Sot ku ta gjësh gruan memece, ka më mirë? Se mos ne që i kemi me gojë ç'hair kemi parë? E po nuse tjetër brenda ditës nuk gjendet... Pastaj se mos e ka parë djali yt e do thotë pse më suallët këtë, unë kisha tjetër. Për atë njësoj është. (*e shkund.*) Tani zgjidh e merr o turpin, o atë që të them unë.

FEMIU — U bëftë ashtu si thua ti.

MURATI — Të lumtë, ma bëre qejfin. Të tjerat i rregullojmë më vonë. (*kthehen në skenë.*)

MURATI — Dëgjo, o krushku i madh, dëgjoni dhe ju, o 'miq. Të ishte si më përpara, sot kishte krisur dyfeku, s'e s'kthehen krushqit pa nuse, po ç't'i bëjmë që kanë ardhur kohë të tjera.

VEIZI — Mos e merr nxituar.

MURATI — Aty dua të dal dhe unë. Gjaku ujë nuk bëhet dhe ne krushqinë nuk do ta prishim. Nusja jonë ishte, dhe jona është. Ne do të vijmë ta marrim kur të thotë krushku, Haxhiu.

HAXHIU — Pas dy javë them unë, siç e kishim.

MURATI — Ashtu qoftë. Bjere dorën.

HAXHIU — Tani uluni të pimë!

MURATI — Do pimë herën tjetër sa të tunden trarët. Tani na fal se jemi përrugë. (*Ndihet një këngë e zgjatur e krushqvë që largohen.*)

HAXHIU — Allah, allah, ç'vajti! (*Duke fshirë djersët.*) Po shqyr që u rregullua më së fundi. (*Psħeretin gjatë.*)

## AKTI I TRETË

### Tablo e parë

*Te pusi i Haxhiut, në të djathtë të shtëpisë. Mbrëmje prilli. Mbi skelën e pusit varet një degë kumbulle e lulëzuar. Matanë gardhit prej kallamesh është Gazzmiri. Shega fshin rrëth e rrotull pusit.*

GAZMIRI — Ma mbush pakë këtë katruven, vetëm këtu te gryka.

SHEGA — Nëma!. (*ja merr katruven.*) E di si më tha babai? «More, si shumë ujë pinë këta të puseve...» «Pse, ujet do t'u kursejmë, o baba?» «Jo, moj jo, s'thom gjë, ma ktheu; le të mbushin sa të duan».

GAZMIRI — Këtu ka qenë kjo kumbulla edhe më përpara?

SHEGA — Këtu!

GAZMIRI — Çudi, s'e paskam vënë re! Dhe, shiko, paska lulëzuar krejt. Kumbullat e lulëzuara ngjajnë tamam si nuse të veshura me fustan të bardhë...

SHEGA — Uh, aman mos na kujto fustanin e bardhë.

GAZMIRI — (*këput një degë të vogël.*) Merri erë. E ke vënë re, lulet e kumbullës bien erë mjaltë.

SHEGA — Kur isha e vogël, ditën e verës, nëna më bënte verore me pe të kuq e pe të bardhë. Pastaj kur i hiqnim veroret nga duart, unë i varja në degën e kumbullës që t'i merrte dallëndyshja dhe të më sillte fat. Dhe unë prisja me frikë a do ta merrte dallë-

ndyshja veroren dhe lutesha gjithmonë të kisha shumë fat. Një mot kam qarë si budallaqe, sepse verorja kishte mbetur varur në degë plot një javë. Duket pastaj nëna e hoqi natën sepse unë të nesërmen që në mëngjez po thërrisja e gëzuar nëpër shtëpi...

GAZMIRI — A të solli fat?

SHEGA — (*Duke e shikuar në sy.*) Shumë.

GAZMIRI — Kjo Myzeqeja në pranverë është e mahnitshme.

SHEGA — Ka shumë bilbili. (*Dëgjohet kënga e një bilbili dhe pastaj një uturimë traktori*). I dëgjon?

GAZMIRI — Bilbilët, hëna, pemët kanë qenë edhe më përpara, po mua më duket se ne e bëmë më të bukur. Shiko si duken dritat e sondave tonë, si yj që i kemi varur në qìell. Dhe zhurmë traktorësh, ndonjëherë dhe uturima e detit.

SHEGA — A ke parë dëborë?

GAZMIRI — Ç'tu kujtua dëbora?

SHEGA — Unë s'kam parë kurrë.

GAZMIRI — Do të shikosh kur të shkojmë në mali.

SHEGA — E si është?

GAZMIRI — E bardhë, krejt e bardhë, ja kështu, si petalet e lules së kumbullës (*kapërcen gardhin*) E di si bien flokët e dëborës? Sikur siten diku lart në qìell, si ato lulet kur i shkund era. Ja, shiko! (*shkund degën e kumbullës e petalet bien mbi të. I afrohet.*) Kristalet e dëborës janë kaqë të imtë dhe të brishtë sa qëllon që mbeten edhe mbi qerpikët e syrit.

SHEGA — Oh, si jam sonte, nuk dua të fle. Doja të kisha një palë krahë të mëdhenj, të mëdhenj e të përqafoja çdo gjë.

GAZMIRI — Mua më ke më afër

SHEGA — Kur kujtoj se ku do isha tashti, më zë tmerri.

GAZMIRI — Iku ajo punë, mbaroi tashti.

SHEGA — Unë isha si e trullosur. Nga njëra anë s'doja, nga ana tjetër më vinte keq t'ja prishja babait.

Si dridhesha atë ditë, nuk do ta harroj kurrë... Rrija në dritaren e mencës dhe më dridhej zemra. E di kur u çlrova unë, kur pashë krushqit që ikën.

GAZMIRI — Tani e hodhe hapin e parë dhe ky ish më i vështirë.

SHEGA — Po tani si do bëj? Babai po pregetitet...

GAZMIRI — Ashtu si të thashë.

SHEGA — Të duket kollaj ty.

GAZMIRI — Dhe ndonjë zor nuk është. Punë e madhe se do veshësh një fustan të bardhë! Zëre sikur je në paradën e modës.

SHEGA — Po nuk është turp?

GAZMIRI — E ndajmë përgjysmë. Bëju pak më e guximshme, merr një çikë shembull nga klasa punëtore. E di, Shegë, Braçja e solli të fejuarën.

SHEGA — Kur kështu?

GAZMIRI — Pardje. Oh, ç'ka vajtur! «U martova» i tha shefit, «po ç'e do, u bëra pishman». «Si!», u habit shefi, «kaqë shpejt? Ti s'ke mbushur javën». «Jo për Sofien», i tha Braçja, «se nga kjo s'më ndan as vdekja, po ç'e do, s'kam ku të rri». «Ama për këtë paske merak?» i tha shefi. «Klasa punëtore nuk të lë në baltë, nesër do ta kesh shtëpinë gati». Dhe sot gjithë punëtorët po i ndërtojnë me punë vullnetare një barakë. Bukur ja hodhi, hë!

SHEGA — Shejtani vetë është.

GAZMIRI — E di sa e duan shokët? Po edhe ai nuk kursehet kurrë për shokët. Qëllon që ndonjë punëtor ka ndonjë hall e do të ikë me lejë. Braçja është i pari që del vullnetar për ta zëvendësuar. (*Ndihet kolla e Haxhiut*).

SHEGA — U, babai! Natën e mirë, Gazmir.

GAZMIRI — Natën e mirë (*Asnjeri nuk largohet. Gazmiri derdh katruven*)

SHEGA — Pse po e derdh?

GAZMIRI — U vjetërua.

SHEGA — Atëhere ta mbushim përsëri.

(*Dëgjohet zëri i Haxhiut*.)

HAXHIU — Po q'u bëre, moj Shegë? U derdh qu-mështi...

SHEGA — (Duke i dhënë katruvën). Mbushe vetë!

### Tablo e dytë

Dasmë në shtëpinë e Haxhiut. Në dhomë disa burra pinë duhan e kuvëndojnë. Në dhomën ngjitur grattë i këndojnë nuses.

«O moj bahça me hurma, me hurma,  
Erdhi hallua e të pa, me hurma,  
Bakshishin në dorë ta la, me hurma,  
Po më dasmë ishalla, me hurma.

— Kemi bërë qejf mbrëmë.

DAJUA — A, na ka kënaqur.

— E tunde, Haxhi, për ideal. Jo se të bëj qejfin, po dasmë si kjo s'është parë në fshatin tonë.

DAJUA — E ke bërë tamam si qëmoti, me të gjitha zakonet. Të ka lezet shpirti.

— A të vajti shumë?

HAXHIU — Për harxhe mos pyet...

NAMIKU — Ato më mirë mos ja kujtoni, se bëhet esëll.

DAJUA — Njeriu një herë martohet.

NAMIKU — Dhe shtëpia një herë prishet.

HAXHIU — Thoni a u kënaqët, a mungoi gjë?

— Të gjitha ishin me bollëk.

NASI — Darkën e shtrove kot, Haxhi. Pas gjithë atyre të pirave e pas gjithë atyre mezeve, kush do hante darkë?

HAXHIU — He, he! e dija unë, po s'kisha si të mos e bënja...

NASI — Tani darkë e meze i bëjmë bashkë. Kështu ka dalë moda.

DAJUA — Jo, zakoni nuk thotë ashtu!

HAXHIU — Mirë e ka dajua. Do të thuash ti se nuk hëngri njeri. Punë e madhe... Unë a u nderova? Kjo ka rëndësi!

— Kur do vijnë krushqit?

HAXHIU — Ata duhet të kishin ardhur, se po afron dreka.

DAJUA — E po të largët, s'dihet si u ka qëlluar. Sulovarët, e thonë të gjithë, janë burra të mirë.

Kush e merr Sulovën? Lushnja apo Gramshi?

NAMIKU — Elbasani, më duket.

— Mbështet vijnë me maqinë.

DAJUA — Me kuaj e me bajrak, kështu e do zakoni.

HAXHIU — Dasmë tjetër unë s'kam në shtëpinë time... Do ta djeg, mor, do ta djeg.

— Do t'ja marrësh një valleje, o Haxhi?

— Merrja asaj dyshes se e hëq mirë.

HAXHIU — Që tani, thojini orkestrës të vijë këtu! (*Fillon të këcejë. Dikush vete ja mban.*)

DAJUA — Hë, më të lumshin këmbët!

HAXHIU — Falenderit e nga zemra juaj.

(*Dikush i qeras.*)

— Me fare do ta bëjmë?

— Me fare. (*Kthejnë gotat me fund.*)

HAXHIU — Gjak e dhjamë. Vetëm një merak më mbeti. Ata të puseve s'më erdhën. Kisha qejf të ishin edhe ata këtu... se...

NAMIKU — Atyre mos u a vu rr re, o xhaxha. Ashtu u ngjau. Shpërtheu gazi në pusin nëntë dhe kanë qysh pardje në drekë që janë mbledhur atje pa luajtur asnjë çast. Mijëra metra kub gaz shkojnë dëm brenda një ore... Në qoftë se do ta mbyllin, do të jetë sukses i madh.

HAXHIU — Për atë Veizin më mbeti merak dhe për atë Gazmirin. A u the, mëre Namik?

NAMIKU — U thashë, o xhaxha, po ata s'mund të lënë punën e të vijnë këtu. Atje ka ardhur ministri, drejtori i ndërmarrjes, sekretari i partisë. E dëgjon si vërvshëllen??. Të jesh atje e t'i shikosh si punojnë, habitesh. Nuk duken si njerëz, po si dragoj.

NASI — A ka rrezik?

NAMIKU — Po si jo. Nga çasti në çast mund të shpërthejë zjarr dhe atë here punëtorët, që janë afér, qaji. E di si fluturojnë gurët përpjetë? Si fije kashte.

HAXHIU — Po 'mirë, le të ikin punëtorët atëhere.

NAMIKU — E kush ta mbyll pastaj?

DAJUA — Axheba, për fshatin ka ndonjë rrezik?

NAMIKU — Për pleqtë po. Mund t'u përcëllohen mustaqet.

DAJUA — Ikë, ore lanet!

NASI — Të fortë janë, për nder.

— Á s'ja marrim dhe një herë?

(*Fillojnë të këndojojnë. Haxhiu shikon vazhdimisht nga dritarja dhe është i shqetëuar. Errësirë*)

HAXHIU — (*i merakosur.*) O Namik, s'po vijnë, mëre nipçë. A thua gjene e kanë ngatërruar atë kaledarë?

NAMIKU — Këtë radhë ti u mëre vesh vetë. S'të kam faj unë. Po vërtet sikur të mos vijnë?

HAXHIU — Tyt, tyt, luaj nga vendi.

NJË ZË — (*Nga jashtë.*) Po vjen një maqinë, po vjen një maqinë...

HAXHIU — Ej, shyqyr, eh shyqyr se më shkruj gjaku. (*ja merr këngës: Uromë, baba uromë.*)

DAJUA — Ata sikur do vinin me kuaj?

NAMIKU — Janë modernizuar, dajo.

HAXHIU — Ajo maqina sikur s'ngjitet në fshatin e tyre...

NAMIKU — Mbësë kanë hipur dhe kuajt në maqinë.

ZËRA — Gëzuar, Haxhi Hasa! Gëzuar! Gëzuar!

Mirëse erdhët! Urdhëroni!

(*Hyjnë punëtorët e puseve Veiz Çika, Spiro Devolliu dhe ndonjë tjetër. Haxhiu ndryshohet në fytyrë.*)

VEIZI — Ç'ke, o Haxhi, pse sikur u vrenjte?

HAXHIU — Jo, urdhëroni, urdhëroni. Zini vend! Ndonjë maqinë tjetër kishte pas jush?

SPIRUA — Ç'ne o! Nuk pamë.

HAXHIU — Mua do më mbetej hatëri po të mos vinit ju.

NAMIKU — Si vajti puna e pusit?

VÉIZI — E mbyllém më këtë. Ja zumë grykën.

SPIRUA — Ama hoqëm, shiko si jemi bërë...

NAMIKU — Kur e mbyllët?

VEIZI — Ja tani, s'ka as dy orë. Gazmiri për pak na la shëndenë.

NAMIKU — Pse, si ngjau?

VEIZI — Ne kishim harruar kapakët e elektro-motorit hapur. Mirëpo atje një shkëndijë duhej dhe merrte fund puna. Gazmiri u sul ta mbyllte, po se si iu dha dhe, para se të ikte, rrëmbeu një helmetë zjarrfikësish dhe e vuri në kokë. Do ti që i bie një gur sa dora mu në kokë? Të mos kish helmetën, iku.

NAMIKU — Po tani ku është?

SPIRUA — Vajti të rruhet. (*Namiku lëshon një uff.*)

VEIZI — Po nuk iu trëmb syri qeratait dhe, kur u kthye nga pusi, mbante gurin në dorë dhe queshte. Unë pér këtë e dua, se është i shakave, po është dhe i punës.

— Haxhi, të kërkojnë!

HAXHIU — Qerasni miqtë! Bëni qejf ju! (*del në derën që të shpie përjashta.*)

VEIZI — Ore, ç'bëhet këtej, se s'po marrim gjë vesh?

NAMIKU — Po ju ç'u bëtë? Mua po më binte të fikët, thashë se po mbetesha fare vetëm.

SPIRUA — Shega si është?

NAMIKU — Pikë mjalti!

VEIZI — Tani që erdhëm ne mos ki merak!

NAMIKU — Tani është sikleti më i madh.

VEIZI — Do t'ja mbushim mendjen Haxhiut se më pér hair do të jetë kështu.

(*Haxhiu kthehet pikë e vrer.*)

HAXHIU — (*duke tundur një letër.*) Nuk më pëlqen mua kjo letër, nuk më pëlqen.

NAMIKU — A e lexove?

HAXHIU — Nuk e lexoj dot, më dridhen duart e më fluturojnë radhët. Ai më dorëzoi letrën e krisi e iku.

— Kush ishte ai?

HAXHIU — Nuk e njoh, nga veshja m'u duk su-lovar. Se ç'u ka ngjarë.. .

NAMIKU — (*lexon pusullën.*) «Haxhi Hasa, turpi lahet me turp. Ne djalin tonë e martuam. Çupa jo-te nuk na duhet. Nuk na e dhe kur e deshëm, mbaje tani se s'na duhet.

Femi Thana.»

HAXHIU — O-o-o-o! Më muar në qafë, më gre-misën, më shuan, më vranë!

Oh i shkreti unë, qysh ta mbaj një turp të tillë mbi kurriz!

SPIRUA — Mbaje veten, Haxhi. S'i ka lezet burrit të bëjë kështu!

HAXHIU — Të poshtërit, ma hodhën, më gënjen-yen, s'paskan qenë burra, paskan qenë kodoshë!

VEIZI — Ç'i do, kur paskan qenë të tillë, ç'i do fare. Më mirë që u prish krushqia.

HAXHIU — Nga t'ja mbaj unë tashti, nga të vete unë, ku të futem unë? Hapmëni një gropë!

SPIRUA — Ç'faj ke ti në këtë mes?

NAMIKU — (*e mban.*) S'ka gjë, xhaxha! Gjëra që ngjasin! Pak ujë pér xhaxhanë.

HAXHIU — Jo, nipçë, më mirë më jep helm. Nderi im mori fund, shtëpia ime u njollos, Haxhi Hasa kaqë e pat!

VEIZI — Në qoftë se ata s'na duan një herë, në nuk i duam njëqind herë, se çupën e kemi si trandafil.

SHEGA — (*duke hyrë*) Baba, ç'ka ngjarë?

HAXHIU — U turpëruam, bijë, u turpëruam! Mbaruam. Krushqit nuk do vijnë! Ç't'u them unë njerëzve! ç't'i them miqësisë? Ah, ta kisha ditur një ditë përpara... Mbaruam, u bëmë stërfis, do na tregojnë bota me gisht.

DAJUA — Zakoni e do që çupa, kur niset nuse, duhet të shkojë te burri, për ndryshe ti si baba dhe ne si fis...

HAXHIU — Dhe çfarë të bëj, mor vëllezër?

DAJUA — Ta martojmë që sonte.

HAXHIU — Ah, sikur të ish e mundur! Ah, sikur të mundja!... Ku ta gjej dhëndrrin tashti se u bë dhe natë. (*hap krahët*) Amani, o miq, më shpëtoni, amani o miq, më gjeni një dhëndërr!

SHEGA — S'ka gjë, baba, unë po e zhvesh fustanin dhe nesër që në mëngjez po shkoj në punë.

VEIZI — Ajo do të bëhet tashti, s'mbetet gjë tjetër.

HAXHIU — (*Shegës*). Pu-pu-pu, mos e zhvish fustanin se është gjynah! Pupupu! më mbeti çupa në derë...

DAJUA — Ne nuk do vëmë re si është e tek është.

HAXHIU — Aman, ore, veç mashkull të jetë!

DAJUA — Eja këtu! (*i vete pranë*) T'ja japim Sherò Narecit.

HAXHIU — Ore Sheros dhe dreqit t'ja japim, vetëm ta nxjerrim nga dera sonte...

SHEGA — Baba, kaqë shumë të jam rënduar?

HAXHIU — Pusho, se s'të ka lezet.

SHEGA — (*me qetësi*) Dhe ja ku po të them: unë s'vete atje!

HAXHIU — Mbylle gojën!

SHEGA — Unë atje nuk vete. E qartë?

HAXHIU — Mbyllë, moj, gojën se je nuse. Nuset, sipas zakonit, duhet të rrijmë një javë pa folur. E di që

një javë s'duron dot, po rri të paktën një ditë.

SHEGA — Më fejove një herë pa më pyetur, dhe unë, me gjithëse nuk e njihja fare, pranova të martoresha, vetëm e vetëm që ti të mos zemëroheshe e të të mos thyhej zemra nga çupa e vetme. Atëherë isha e vogël dhe më gënjeve po tani s'kam si të pranoj.

HAXHIU — Atëherë vramë mua... Vramë më mirë! Kush ka një thikë?

SHEGA — Ti po më vret mua me këtë që kërkon të bësh.

HAXHIU — Pse, moj çupë, Sherua nuk është i keq. Ai i ka të gjitha të mirat...

SHEGA — Është plak.

DAJUA — Moj çupë, në këso rastesh nuk shikohen vjetët!

SHEGA — E si thua ti, dajo, të kem më të ri babanë se burrin?

HAXHIU — E, e, e, se mos e kemi marrë jetën me tapi! Ku dihet kush vdes përpara. Ai mund të rrojë dhei dyzet vjet.

VEIZI — I ka ngrënë nja tre gra ai, mirë thotë.

SHEGA — Do më hajë dhe mua, prandaj nuk e duau.

HAXHIU — Jo, moj, se nuk të ha. Ai është me një këmbë në varr.

SHEGA — Jo, jo, jo. Unë po iki të zhvishem (del.).

SPIRUA — Ju po i bëni hesapet pa hanxhinë. A pranon Sherua? Se ju s'i kini thënë kurgjë. Këto bisedat tuaja deri tani janë kot.

VEIZI — E ka mirë Spirua.

DAJUA — E pse të mos pranojë? Ai veç në qoftë i çmendur... Ku do gjejë më të mirë?

SPIRUA — Ku dihet? Mendje i thonë...

— Të dërgojmë një njeri te Sherua.

NAMIKU — Vete unë!

HAXHIU — Jo, jo, se ti do na ngatërrosh. (duke iu drejtuar një tjetrit.) Shko ti e i thuaj kështu e kështu. Pastaj të kthehesh me vrap sa më parë. Ai nuk e ka dhe shumë larg shtëpinë.

NASI — Ore shoku Namik, është në vete ky? Na i prishën gjithë planet.

NAMIKU — Foli ti, si anëtar i këshillit, se mua s'më dëgjon.

NASI — Haxhi, kisha një fjalë me ty.

HAXHIU — Urdhëro.

NASI — Ti e di që unë të nderoj.

HAXHIU — Po, po.

NASI — Ti e di që unë të dua...

HAXHIU — Unë të dua më shumë.

NASI — Atëhere a do të më dëgjosh?

HAXHIU — Si jo? Po të mos dëgjoj ty, kë do dëgjoj unë?

NASI — Unë e di pse u nxitove ta martoje Shégén fët e fët... Se mos kushedi...

HAXHIU — Jo, për nder... : Ata vetë...

NASI — Lëri ato, se e di unë atë punë. Megjithatë, unë erdha edhe në dasmë sa për një urim, që mos të tē mbetet hatëri.

HAXHIU — Ju falemnderit shumë.

NASI — Ne ta bëmë qejfin, ti tani pse na e prish?

HAXHIU — Ç'farë prish unë i ziu, ç'farë prish? Unë jam bërë për të vrarë veten. Po a ka si turpërohet burri më shumë? Më thuaj shoku Nasi si të bëj, se ti di më shumë se unë.

NASI — Kjo që kërkon të bësh ti, është gabim i rëndë.

HAXHIU — Ama, ç'ma dashke të mirën...

NASI — Ti po bëhesh kriminel i vajzës tënde. Po e marton kundra dëshirës së saj.

HAXHIU — Kështu thotë zakoni: Çupa e nisur nuse, nuk mund të rrrijë më shumë se 24 orë në shtëpi-në e babait.

NASI — Po na turpëron dhe ne. Kjo që po bën ti është në kundërshtim flagrant me normat dhe ligjet.

DAJUA — Zakoni kështu e do. Qysh, ta mbajë çupën Haxhiu në shtëpi tashti?

NASI — Këto zakone janë vjetëruar.

HAXHIU — Poo, qenkan vjetëruar... E di unë pse më thua kështu ti, se s'ndodhi në shtëpinë tënde kjo që më ngjau mua. Po të të kish ndodhur atje, pa të të shikoja si do flisje. Ti s'do të mirën time, ti do turpin tim.

NASI — Dëgjo, në qoftë se nuk heq dorë nga kjo mendje, unë nuk shkel më në këtë shtëpi.

HAXHIU — Kurrë mos ardhç!

NASI — Do të të dalë keq!

HAXHIU — Më keq se kaqë, s'ka ku vete.

NASI — Me këtë njeri s'merresh dot vesh. Po ne si pushtet nuk do ta lëmë këtë punë kështu. Ne do marrim masa. Ky po e marton të bijën me forcë.

HAXHIU — Unë me forcë? Ajo do të martohet vetë, unë s'mund ta pengoj... (*Shegës që është te dera*) Bijë e babait, më ke në dorë, bëj si të duash, vramë ose shpëtomë. (*Nasi dhe Namiku mëten të dalin*)

VEIZI — Nuk e lëmë ne të vejë atje. Flijeni mendjen.

(*Në këtë çast hyn Gazmiri. Ai pyet me sy Shegën për të marrë vesh si qëndron puna. Ajo është gjithë inat*)

GAZMIRI — Si është puna? Ç'ka ngjarë?

VEIZI — Këta po e përbysin situatën.

GAZMIRI — Kush kështu?

NAMIKU — Na djallosën, duan ta martojnë që sonte me Shero Narecin.

GAZMIRI — Ou!

HAXHIU — (*Vazhdon t'i lutet*) Turp për shtëpi-në tonë e sidomos për ty. Mbeti nuse në derën e babait, do të thonë bota dhe do më tregojnë me gisht.

SHEGA — Do të të them dhe një gjë tjetër? Unë e dija që nuk do vinin krushqit, megjithatë u nisa nuse. (*Haxhiu, Dajua çakaritin sytë, disa gra zënë faqet me duar.*)

HAXHIU — Po pse moj pikérënë, pse?

SHEGA — Për t'ju bërë qejfin juve. Mos ju gjeti ndonjë e keqe? Hëngërt, pitë, kënduat, kërcyet, tanig'doni më?

HAXHIU — Pika, o çupë! Pika të të kish rënë më mirë.

DAJUA — Aha, s'marrim vesh, ku është nderi, ku është turpi.

SHEGA — Ti dajo, mos thërrit shumë. Në solle një palë këpucë për martesë, urdhëro këpucët! (*Ja zbatch e ja jep në dorë*)

DAJUA — Nuk i dua. Gjë e falur s'kthehet prapë.

SHEGA — Këto këpucë ti i kishe për çupën tën-de. Po ajo iku e t'i la në dorë se u martua me atë që deshi, dhe ti m'i solle mua. As unë nuk t'i dua.

HAXHIU — Shiko çupë e babait, s'të jam lutur kurrë, kurse sot po të lutem. Bëja qejfin babait, mos e turpëro, mos m'i nxi këta vjet që më kanë mbetur, mos më bëj të mbyllem brenda. Nuk e duroj dot këtë turp, nuk e duroj dot. Në pësosfsha gjë ta dish, nga ti e kam...

SHEGA — Jo, jo.

HAXHIU — Po merre një herë, makar sa për sy e faqe të botës, pastaj shohim e bëjmë, si të jetë më mirë...

NAMIKU — Ashtu nuk bën, o xhaxha.

HAXHIU — Pusho ti, se nga ti erdhën të gjitha këto ngatërresa. Ju i kini kurdisur...

NAMIKU — Jo nga unë, xhaxha, nga ti. A mban mend kur më thoshe «mblesëria» s'ka asgjë të keqe? Urdhëro e shikoje tashti.

HAXHIU — Folë, më paç uratat!

(*Shega hesht. Dikush përjashta ja merr kënges, një këngë të çakërdisur dhe të stonuar. Sherua ka dërguar dy-tre njerëz për të marrë nusen. Gazmiri i bën shenjë Shegës që të pranojë.*)

SHEGA — (me inat.) Edhe ti... edhe ti...

(Gazmiri i bën shenjë përsëri, po këtë herë she-njën e vë re Haxhiu).

HAXHIU — Aaaa! Kështu me shenja s'ka lezet... Ç'po i thua ti ashtu prapa krahëve? A! U bëmë si këmbët e dhisë. Ku jemi këtu, në thjatro apo në shtëpi?

GAZMIRI — (I zënë ngushtë.) Hiç, asgjë!

HAXHIU — Si hiç? Mua do ma hedhësh ti? Ti thua mbyll sytë të të gënjej.

GAZMIRI — E, pra, ato që ja thashë me shenja mund t'i them edhe me fjalë në sy të të gjithëve: «Mërrë atë që të thotë babai. Ai e ka mirë, ti duhet ta dëgjosh...»

SHEGA — Jo, nuk dua, nuk dua!

GAZMIRI — Unë, si shok pune, këtë të them. (i bën shenjë që të pranojë.)

SHEGA — Mirë, baba...

HAXHIU — Ashtu! Ashtu më rrofsh. Tani po, ma bëre qejfin. Ashtu më paç uratën (e puth). (i drejt tohet Gazmirit). Edhe ti më paç uratën.

(puth edhe Gazmirin)

(Hyjnë dy-tre veta të dërguar nga Sherua.)

— E po gëzuar, o Haxhi!

— Gëzuar, Haxhi. Të na trashëgohen!

HAXHIU — (thatë) Gëzuar!

— Paska fat ai Shero Nareci.

— Mirë thonë, derri i çalë e ha dardhën e mirë.

NAMIKU — Gazmir, s'e kam pritur këtë prej teje.

GAZMIRI — Po ç'mund të bëj tjetër.

NAMIKU — Ti më duket s'je në vete.

GAZMIRI — Ti s'je në vete.

— Të mos e zgjatum shumë se u bë natë.

GAZMIRI — I shpiem ne me maqinën tonë. Kështu ka edhe lezet.

HAXHIU — Oh, sikur ta bëni atë të mirë.

VEIZI — Pse jo, ne e kemi punonjësen tonë.

SHEGA — Unë s'po marr vesh gjë.

GAZMIRI — Bisedojmë në maqinë, tanë ndahu me babanë.

(Ata dalin ta përcjellin. Pas pak ndihet zhurma e maqinës që largohet. Haxhiu e Namiku kthehen.)

HAXHIU — Ej, shyqyr, shyqyr, ku u ndodh ai Gazmiri, ai e bindi se po ngulte këmbë si mushka, Shyqyr s'më mbeti turpi mbi kurriz. Oh, ç'kam he-qur, ç'kam pësuar, unë e di.

(Fshin djersët me shami dhe çfrym) Tani pastro-ni shtëpinë e më jepni të pi.

NAMIKU — Nuk të vret ndërgjegja o xhaxha? E vrave me duart e tua.

HAXHIU — Atje qe fati, o nipçë. Atje qe e shkruar, atje u bë.

NAMIKU — Njeriu vetë e ka në dorë.

HAXHIU — Po ja që s'e paska... Rri, o nipçë, se shpëtuam mirë. Kur të marrin vesh Sulovarët, do pël-casin nga inati. Kjo ka rëndësi. Çupa kur është e vogël, është xhevair, kur rritet është flori, kur mbetet pa martuar është plehë. Ne shpëtuam mirë. M'u bë mendja dhallë, tani dua një muaj të marr veten. U bë-më të na qeshin bota.

NAMIKU — A nuk të thashë që do të tallet koha me ty?

HAXHIU — Po ç'më shet mend ti mua? S'është puna e kohës...

NAMIKU — Ke të drejtë, s'është puna e kohës, është puna e kokës. Juve ju janë ngatërruar zakonet si litarët nëpër këmbë dhe s'ju lënë të ecni. Xhaxha, hiqi këmbët nga ky litar!

(Në këtë kohë hyn Shero Nareci)

SHERUA — Ku ma ke nusen o Haxhi!?

HAXHIU — (Me psherëtimë.) E pate fat. S'ishe ti për atë nuse; po ç't'i bësh, ashtu ngjau...

SHERUA — Po pse të tallesh me mua pse? Më the se do ta dërgoj dhe s'ma dërgove.

HAXHIU — Ta dërgova o Shero dhe bile me maqinë.

SHERUA — Po maqina qëndroi sa zbritën njerëzit

e mij, kurse nusja nuk zbriti, ata e muar dhe ikën... ikën...

HAXHIU — A!

SHERUA — Njëri nga ata më tha: S'e kafshon dot këtë mollë se je plak e të mbeten dhëmbët.

HAXHIU — (Me habi) A!

SHERUA — Unë dua nuse...

HAXHIU — Një çupë që kisha ta dhashë, tjetër nuk kam.

SHERUA — Jo, unë e dua.

HAXHIU — E po, veç të bëhem unë nuse! (*Haxhiu kollitet.*) Ato shenjat s'më pëlqyen mua... Thua të jetë e vërtetë?

SHERUA — Si the?

HAXHIU — Ikë ore tutje, se s'bëje ti pér atë. (*Sherua ikën duke murmuritur*) Po ku ka vajtur xhanëm? Ah, ato shenjat... ato shenjat. Namik, Namik, ma hodhët gjene. Pa eja këtu! Pa më thuaj ku vajti, se më është bërë mendja dhallë e s'po marr vesh gjë fare.

NAMIKU — Nuk e di.

HAXHIU — Po ç'më shet mend ti mua! E di dhe s'do të tregosh. Xhaxhait ja bën këtë gjëra... hë?

DAJUA — Tregoi xhaxhajt! Mos ka ndërmend të martohet me atë Gazmirin? Thuaj tashti, u bë ç'u bë.

NAMIKU — Deri më tanj jo, më tutje nuk e di. Sidoqoftë xhaxha, Shega meqë s'mori atë që i dhe ti, tanj do marrë atë që të dojë vetë.

HAXHIU — Në e ka pér të marrë, ta marrë që sonte. Kështu e do zakoni.

NAMIKU — Aha, mbaruan ato zakkone, xhaxha.

F U N D